

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXIII i botimit, nr. 258, Prill 2025

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër, Tel. +355685000229, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Klodjana Serraj, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro



Papa Françesku, miku i popullit Shqiptar



Papa Françesku Faleminderit dhe lutu për popullin Shqiptar

E gjithë bota me pikëllim vajton Papën Françesku, i cili pati afërsinë me çdo person si shenjë dalluese të papnisë së tij, që zgjati 12 vjet. Jorge Mario Bergoglio, i cili erdhi "pothuajse nga fundi i botës" Argjentina, ndërroi jetë në moshën 88-vjeçare, ditën e dytë të Pashkëve, të Hënën e Ngjalljes së Krishtit.

Pas njoftimit për vdekjen e tij, që ndodhi, në orën 7. 35 të mëngjesit të hënën e kaluar, më 21 prill 2025, vijnë mesazhe ngushëllimi nga e gjithë bota, ndërsa me mijëra e mijëra njerëz vijnë të dynden në Sheshin dhe Bazilikën e Shën Pjetrit, në Vatikan, për t'u lutur për Papën e ndjerë.

Një Papë që pushtoi besimtarët dhe jobesimtarët. Një Papë "reformist" në emër të vëmendjes ndaj më të varfërve dhe të mënjuarve, të atyre personave që ishin të fundit të shoqërisë, madje të hedhur e të refuzuar, një Papë sipas Lumturive Ungjillore, të cilat ai vetë i ka treguar vjimisht si busull që duhet ndjekur në misionin, që i qe besuar nga Jezu Krishti.

Shërbëtor i Zotit, me thjeshtësi e vëllazëri

Temat kryesore që përfaqësojnë të magjisterit e Papës Bergoglio janë: vëllazëria dhe dialogu ndërfaqësor, periferitë dhe emergjencat klimatike, pajtimi dhe besimi, feja në Zotin dhe respekti ndaj njeriut, luftimi i varfërisë, zhvillimi e pasuria në shërbim të së mirës së përbashkët.

Sigurisht, ka qenë Papa i parë jezuit. Jezuitët përpiqen të jenë shërbëtorë të Kishës, por Bergoglio pranoi, duke menduar se ishte detyrë e tij t'i shërbente Kishës e njerëzimit me thjeshtësi të madhe, siç e pamë, dhe me frymë universaliteti.

Vëllazëria është rruga drejt paqes

Vëllazëria dhe dialogu: dy fjalë që kanë karakterizuar papninë e Bergoglios, i cili ka nënvizuar vjimisht nevojën për të krijuar "ura" midis feve dhe kombeve, në mënyrë që të mos dorëzohemi para realitetit të sotëm dhe një e ardhme e karakterizuar nga luftërat dhe dhuna.

Nga paqja tek kujdesi për të pambrojturit

"I thjeshtë. i drejtpërdrejt. Kundër rrymës. Guximtar. Befasuese. I mprehtë. Njerëzor. Universal. Shenjtë": këto janë shprehjet që përsëriten në fjalët e atyre njerëzve që u rreshtuan dhe vijnë të presin radhën për t' dhënë lamtumirën e fundit Papa Françeskut. Dhe vërtet ka njerëz të gjitha llojeve e kategorive në vargun e pafund që fillon në Piazza Pia, vijon përgjatë via Conciliazione, e pastaj përshkon Piazza San Pietro dhe mbërrin në Bazilikën e Vatikanit, për ta parë Françeskun, për ta përshëndetur, për ta falënderuar, për t'u lutur.

Udhëtimi i parë evropian i Papës Françesku ishte ai në Shqipërinë e vogël, ku ende ndihej martirizimi i Kishës Kato-

like e i gjithë popullit, por ku dëshmohej forca e bashkëjetesës ndërfaqësore. Ati i Shenjtë Bergoglio e tregoi me fakte se vërtet i deshi shumë shqiptarët, nga gjiri i të cilëve doli Nënë Tereza, përmendur shpesh në homelitë e fjalimet e tij.

Papa Françesku pati një lidhje të veçantë me Shqipërinë e shqiptarët, të cilët deshi t'i vizitonte të parët në Evropë. E përmendte shpesh edhe shenjtën shqiptare të bamirësisë, Nënë Terezën, pikë referimi për mënyrën se si duhet të qëndrojnë në botë një Kishë gjithnjë në lëvizje, e konceptuar nga Ati i Shenjtë si spital fushor, pra, si një vend për të shëruar plagë e për të ngushëlluar njerëzimin, gjithnjë për udhë, pa u ndalur kurrë, me rrënjë të thella në traditë.

Vizita në Tiranë

Edhe për vizitën e parë të Papës Françesku në Evropë, data ishte 21, si ajo e sotmja, kur gjithë bota vajton humbjen e Pasardhësit të Shën Pjetrit, por muaji ishte i ndryshëm. Ishte 21 shtatori i vitit 2014 - vetëm pak muaj nga zgjedhja e Bergoglio-s dhe nga fillimi i papnisë së tij - kur Papa shkoi për një vizitë njëditore në Tiranë, me dy synime: t'u bënte homazh martirëve shqiptarë të komunizmit, që u persekutuan për të mos e mohuar Krishtin, "deri në flijim", siç tha edhe vetë Ati i Shenjtë në kryeqytetin e Shqipërisë; e, së dyti, të vinte në dukje modelin e bashkëjetesës paqësore ndërmjet feve në atdheun e shqipeve, që është "vëllazërim" - nënvizoi gjithnjë në Tiranë - e, jo thjesht "tolerancë".

Edhe motoja, me të cilën e pritën ipeshkvijtë, kleri dhe besimtarët katolikë ka disi të bëjë me Jubileun e sivjetëm kushtuar shpresës, shpallur po nga Papa Françesku. Ishte: "Së bashku me Zotin, drejt shpresës që nuk zhgënjën". Ati i Shenjtë, pasi u prit në Pallatin Presidencial (atëherë ishte president, Bujar Nishani), kremtoi meshën në Sheshin Nënë Tereza të Tiranës, ku tha edhe Engjëllin e Tënzot. Pastaj, në Universitetin katolik Zoja e Këshillit të Mirë, takoi krerët e emërtimeve të ndryshme të krishtera dhe ata të bashkësisë myslimane, sunitë e bektashinj. Pasdite, në katedralen e Shën Palit në Tiranë, u foli ipeshkvijve, meshtarëve, murgeshave, rregulltarëve e seminaristëve katolikë, me përqaftimin e tij të paharrueshëm e përlojtjen ndërsa takonte të mbijetuarit e komunizmit, motër Maria Kaletën dhe don Ernest Simonin, tashmë kardinal. Së fundi, përshëndetja me fëmijët e Qendrës Betania, pranë Tiranës, si edhe me një përfaqësi të asistuarish nga qendrat bamirëse të Kishës Katolike anembanë Shqipërisë, të shoqëruar nga vullnetarët.

Shqipëria, pati thënë Papa Françesku, është 'tokë heronjsh, që sakrifkuan jetën për pavarësinë e vendit dhe tokë martirësh, që e dëshmuuan fenë në kohët e persekutimit' kundër Kishës Katolike; pati kujtuar edhe vëmendjen që autoritetet ci-

vile tregojnë ndaj Selisë së Shenjtë, e cila, nga ana e saj - pati premtuar Papa - nuk do të mungojë ta mbështesë vendin në dialogun me besimet fetare dhe në rrugën drejt integritetit në familjen e popujve evropianë, ku Shqipëria jo vetëm merr, por edhe sjell vlerat, që e kanë dalluar.

Viti 2016: shenjtërimi i Nënë Terezës, lumnimi i martirëve

Viti 2016 ishte vit i veçantë hiri për shqiptarët. Papa Françesku shpalli shenjtën misionaren shqiptare të bamirësisë, Nënë Terezën, më 4 shtator, ndërsa i dërguari i tij, kardinali Angelo Amato, prefekti i atëherëshëm i Kongregatës për Çështjet e Shenjtorëve, kremtoi meshën për shpalljen e 38 martirëve të parë të komunizmit në Shqipëri, më 5 nëntor, në Shkodër.

Nënë Tereza, shenjte e njohur si e tillë jo vetëm nga katolikët, por edhe nga hinduistët, budistët, taoistët, shintoistët, myslimanët e hebrenjtë, u shpall e Lume nga Papa Gjon Pali II, në vitin 2003. Gjatë homelisë së meshës, kremtuar në Sheshin e Shën Pjetrit, në Vatikan, Papa Françesku pati thënë:

"Misioni i saj (i Nënë Terezës) në periferitë e qyteteve dhe në periferitë ekzistenciale mbetet, në ditët tona, dëshmi e qartë e afërsisë së Zotit me më të varfërit ndër të varfërit. Sot, unë ia dorëzoj gjithë botës së vullnetarëve këtë figurë emblematike të gruas dhe murgeshës: qoftë modeli juaj i shenjtërisë!"

E pastaj, me mënyrën popullore të të folurit, që e karakterizonte, Papa shtoi:

"Mendoj se, ndoshta, do ta kemi pak të vështirë ta quajmë Shën Tereza: shenjtëria e saj është aq afër nesh, aq e butë dhe frytdhënëse, saqë spontanisht do të vazhdojmë ta quajmë "Nënë Tereza". Kjo veprimtare e palodhur e mëshirës na ndihmoftë ta kuptojmë gjithnjë e më shumë se kriteri ynë i vetëm për veprim është dashuria pa interes, e lirë nga çdo ideologji e nga çdo kufizim dhe e derdhur mbi të gjithë pa dallim gjuhe, kulture, race apo feje. Nënë Terezës i pëlqente të thoshte: "Mund të mos e flas gjuhën e tyre, por mund t'u buzëqesh". Le ta mbajmë në zemër buzëqeshjen e saj dhe t'ua dhurojmë atyre, që takojmë për udhë, veçanërisht, të vuajturve. Kështu, do të hapim horizonte gëzimi dhe shprese për kaq shumë njerëz të shkurajuar, që kanë nevojë për mirëkuptim e dhembshuri".

Ishte gjithnjë dekreti i Papës Françesku ai që, më 5 nëntor të po atij viti, në katedralen e Shën Shtjefnit, në Shkodër, bëri të ngrihen në nderimet e altarit e të shpallen të Lum 38 martirët e parë të krishterë, persekutuar, torturuar e martirizuar gjatë përpjekjes së regjimit të Enver Hoxhës për ta dëbuar Zotin nga Shqipëria. Dhjetë mijë besimtarë morën pjesë në meshën e kryesuar nga prefekti i Kongregatës për Çështjet e Shenjtorëve, kardinali Angelo Amato, i dërguar i Papës, i cili pati theksuar vlerat e shqiptarëve, që i pëlqenin Atit të Shenjtë: "Edhe në ferrin e një persekutimi ar-



Shenjtërimi Nënë Terezës



bitrar dhe të padrejtë, martirët shqiptarë treguan ndaj armiqve të njëjtat ndjenja dhe qëndrime të Krishtit: faljen, vëllazërimin, qëndresën, vëllazërimin, mëshirën. Ata janë dëshmitarë të atij njerëzimi të ri, që nuk mbjell në histori luftëra, përçarje e vrasje të pafajshmish, por paqe, gëzim dhe vëllazërim”.

Në 550-vjetorin e vdekjes së Gjergj Kastriotit

Dy vite më vonë, më 19 nëntor 2018, Ati i Shenjtë pret në Vatikan një përfaqësi shqiptarësh nga të gjitha trevat e banuara prej tyre në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi e gjetiu, me rastin e 550-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, “Athleta Christi”. Ngjarja u organizua nga ambasada e Shqipërisë në Selinë e Shenjtë, me kujdesin e veçantë të së ngarkuarës së atëhershme me punë, aktualisht ambasadores Majlinda Frangaj. Edhe atëherë, duke vënë në dukje bëmat e Kastriotit, Papa nuk mungoi ta ngrejë lart popullin shqiptar. “Pak herë në histori – pati thënë ai – një individ i veçantë ka mishëruar në mënyrë kaq të qartë e në masë kaq të madhe virtytet e një populli, deri në atë pikë sa që është e vështirë t’i kuptohet shpirti pa u ndalur e pa marrë parasysh parimet dhe vlerat, që e frymëzuan atë personazh”.

Papa nuk pati harruar të përmendë Vitin kushtuar Skënderbeut e, edhe arbëreshët e Italisë, duke vënë në dukje lidhjen e tyre me tokën e origjinës. Duke e dhënë bekimin e tij për të pranishmit e për popullin shqiptar, me kujtimin e martirëve e të Nënë Terezës, Papa, edhe



Vizita në Memorialin e Nënë Terezës, në Shkup (Vatican Media)

atëherë, la këtë mesazh:

“Uroj sinqerisht që ky përvjetor (550-vjetori i vdekjes së Skënderbeut) të mos kufizohet vetëm në kremtimin e lavdisë së bëmave të kaluara, por të jetë edhe për Shqipërinë një rast i volitshëm për një angazhim të ripërtërirë nga të gjithë, institucione dhe qytetarë, në favor të një zhvillimi të vërtetë e të ekuilibruar, në mënyrë që brezat e rinj të mos detyrohen të zgjedhin emigracionin, duke dobësuar vendin nga forcat dhe aftësitë e domosdoshme për zhvillimin e tij njerëzor e civil”.

Tërmeti i vitit 2019

Një vit më vonë, vit tejet i vështirë për Shqipërinë, për shkak të tërmetit të fuq-

ishëm, që shkatërroi sidomos qytetin e Durrësit dhe fshatin e Kodër - Thumanës, mendimi i Papës jo më larg se të nesërmen, gjatë audiencës së përgjithshme të 27 nëntorit, shkoi drejt “popullit të dashur” të Shqipërisë.

“Dua t’i dërgoj përsëritjen dhe afërsinë time popullit të dashur shqiptar, i cili ka vuajtur kaq shumë këto ditë. Shqipëria ishte vendi i parë në Evropë që desha të vizitoj. Jam pranë viktimave, lutem për të vdekurit, për të lënduarit, për familjet. Zoti e bekoftë këtë popull, që e dua shumë”.

Emërimet e ipeshkvijve

Papa Françesku ka vijuar të ndjekë gjithnjë me vëmendje Kishën Katolike dhe popullin në trevat shqiptare, së pari, përmes vizitave “ad Limina” të ipeshkvijve në Vatikan, gjatë të cilave Ati i Shenjtë është informuar periodikisht për gjendjen e besimtarëve e të popullit, në përgjithësi. Pastaj, përmes emërimeve të ipeshkvijve të rinj, si imzot Gjergj Meta në Rrëshen (aktualisht, kryetar i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë), imzot Arjan Dodaj si kryepeshkëv metropolit i Tiranë - Durrësit, imzot Giovanni Peragine si koadiutor në kryepeshkvinë metropolit të Shkodër - Pultit, imzot Simon Kulli si ipeshëv i Sapës.

Lutja për Nënë Terezën

E pastaj, takime të tjera me besimtarët në Vatikan, me përfaqësues të bashkësive të ndryshme fetare e me krerë të shtetit e të qeverisë nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia ... Pikërisht, në këtë të fundit, gjatë vizitës në Memorialin e Nënë Terezës, më 7 maj 2019, Papa Françesku bekoji gurin e parë për shenjtëroren e shenjtës shqiptare, dhe, duke iu lutur, përsëriti atë, që ishte programi i tij i papnisë:

“Të lutemi: ndërmjetëso pranë Krishtit, që edhe ne të fitojmë hirin për të qenë vigilentë dhe të vëmendshëm ndaj britmës së të varfërve, të atyre që janë privuar nga të drejtat, të sëmureve, të mënjanuarve, të fundmëve. Zoti na dhashtë hirin ta shikojmë në sytë e atij, që na shikon, thirrjen për ndihmë! Na dhashtë zemër që di ta dojë Zotin e pranishëm në

çdo burrë e çdo grua; zemër, që di të shohë në zemrën e atyre, të cilët vuajnë nga padrejtësitë. Na dhashtë hirin të jemi edhe ne shenjë dashurie dhe shprese në kohën tonë, që ka shumë nevojtarë, të braktisur, të shtypur dhe emigrantë. Bëj që dashuria jonë të mos jetë vetëm fjalë, por të jetë e frytshme dhe e vërtetë, që ta dëshmojmë besueshëm Kishën, e cila ka për detyrë t’u predikojë Ungjillin të varfërve, çlirimin robërve, gëzimin të sfliturve, hirin e shëlbimit të gjithëve”.

Lumturimi i martirëve Atë Luigj Palaj, ofm dhe dom Gjon Gazulli

Lumturimi i martirëve Atë Luigj Palaj, ofm e dom Gjon Gazulli, në nderimet e altarit të Kishës dhe të Kombit, më 16 nëntor 2024, në Katedralen e Shkodrës. Ishte një tjetër vendim dhe dhuratë e çmuar që Papa Françesku i bëri dhuratë Kishës katolike ndër shqiptarë.

Në Qytetin e Romës e në Vatikan këto ditë të trishtuara mbërrijnë grupe besimtarësh të krishterë, shtegtarësh, turistësh ... Pas vdekjes së Atit të Shenjtë Bergoglio, më 21 prill, të Hënën e Pashkëve, mbi 90 000 vetë e vizituan Bazilikën e Shën Pjetrit vetëm në 24 orët e fundit, për t’i bërë homazhe Papës Françesku, duke përfshirë edhe 13 000 vetë mbrëmë, nga mesnata deri në orën 2. 30 të mëngjesit. Aktualisht mbi 120 000 persona kanë shprehur nderimet e janë lutur për Papën e ndjerë, pas një radhe prej dy kilometrash në pritje për të kapërcyer dyert e Bazilikës së Vatikanit.

Në një rrjedhë të pandërprerë, mijëra njerëz me prejardhje të ndryshme vijnë të mblidhen para trupit pa jetë të Atit Shenjt argjentinas, Papës së 266-të të Kishës, arkivoli i të cilit do të mbyllet sot, 25 prill, në orën 20.00 të mbrëmjes, në Bazilikën e Shën Pjetrit.

Në një atmosferë lutjeje, me rruzaret në duar e lotët në sy, besimtarët kërkojnë ndërmjetësimin e Virgjërës Mari, për prehjen e shpirtit të Papës Françesku, “që u kthye në shtëpinë e Atit, pasi ia kushitoi gjithë jetën shërbimit të Zotit dhe të Kishës së tij”.

Disa nga reagimet e shtegtarëve, të cilët, të trishtuar nga vdekja e tij, e quajnë “Papa i të varfërve e bariu i mirë”, i cili, siç u shpreh Kamerlengu i Kishës Universale, Kardinali Farrell pas njoftimit të vdekjes së tij, të hënën e kaluar, kur tha: “Françesku na mësoi të jetojmë vlerat e Ungjillit me besnikëri, guxim dhe dashuri universale, veçanërisht në favor të më të varfërve dhe më të braktisurve”.

Qeveria Shqiptare, datën 26 prill 2025, ditën e Shtunë, në nderim të Atit të Shenjtë, Papa Françesku, me rastin e varrimit të tij, e ka shpallur Dite Zi-e dhe me këtë rast uljen e Flamurit të Kombit tonë, në gjysmë shtize!

Përgatiti: Roza Pjetri



Papa Françesku në katedralen e Shën Palit, Tiranë




Dita e librit! Libri në Shkodër - Përhapja, tregtimi dhe persekutimi

Dita e librit, data 23 prill ...

Shkodranët e kanë dashur librin, kanë punuar me te dhe e kanë shfrytëzuar për ti shërbyer Shkodrës dhe Shqipërisë. Vetë fakti që i pari libër shqip që njihet deri sot, është "Meshari" i Gjon Buzukut, tregon se ai lindi nga trevat veriore të vendit. Nga hapësira shkodrane janë edhe autorë të tjerë që kanë botuar në shekullin XVI - XVII, që pavarësisht se ishin fetare, ato mbanin gjallë shqipen.

Shumë libra u botuan jashtë vendit. Kështu, fjalori i parë i gjuhës shqipe i Frang Bardhit u botua në Romë me 1635. Të dhëna për praninë e librit në Shkodër jep At' Vinçens Malaj, i cili në veprën "Të dhëna albanologjike", duke folur për benediktët dhe veprimtarinë e tyre në Shqipëri (bazuar në të dhënat e Farlatit në veprën "Illyricum Sacrum"), shënon se, qendra të rëndësishme të administratës e kulturës me arkiva dhe biblioteka të famshme, kanë arqipeshkvitë e Durrësit, Tivarit, Shkodrës e Shkupit. I njëjti autor tregon se, në bibliotekën e domenikanëve në Split, me tërheqjen e këtyre nga Shqipëria, ruhen 7 libra koralë (4 gradualë e 3 anifore) shkruar në pergamenë nga shekulli XV. Për historinë e librit me rëndësi janë edhe dëshmia mbi analet historike (dorëshkrimeve) për Shkodrën dhënë nga Barleti në "Rrethimin e Shkodrës". Po kështu njihen përpjekjet e Bogdanit (1638) për të shpëtuar librat nga turqit. Ekzistenca e librave në Bibliotekën e Myftinisë së Tabakëve në Shkodër, sidomos të dorëshkrimeve të saj paraqesin lëndë të rëndësishme për nga ana e përpilimit që u përngjet kronikave të latinëve dhe atyre të mesjetës. Hapja e disa shtypshkronjave në Shkodër, si ajo e Vilajetit të Shkodrës, e Etërve Jezuitë, Dom Ndoc Nikaj, e Etërve Françeskanë, e Djepaxhijeve e të tjera, rriti mundësinë e shtypjes së shumë librave dhe shpërndarjes së tyre jo vetëm

në Shkodër por në të gjithë Vilajetin e saj. Burim i përhapjes së librave në Shkodër u bënë bibliotekat e Bushatlinjëve, Tabakëve, Jezuitëve, Françeskanëve, Komisioni Letrare, Biblioteka e Shtetit "Marin



Barleti", e Universitetit "Luigj Gurakuqi", e Muzeumit, e të tjera.

Tregtimi i librit në Shkodër është një aspekt tjetër i historisë së librit, që tregon për një ecure pozitive nga vetë zhvillimi i qytetit të Shkodrës parë në çdo pikëpamje. Libraritë e para në qytetin e Shkodrës kanë qenë e Filip Shirokës - e vendosur tek Dugajtë e reja; Librari Laçej,- pronë e Xhemal Laçej- e vendosur pranë pronave të Topallejve; kancelari-librari Nikshiqi,

librari "Broja" - në qendër të qytetit. Librat në libraritë e Shkodrës ishin më tepër në gjuhë të huaj ose përkthime. Deri në v. 1944 në Shkodër numëroheshin afro 70 gazeta e revista kulturore fetare. Sipas At Donat Kurtit, rreth librave të botuar nga elementi katolik i qytetit në vitet 1555 - 1942, llogarit 460 vepra të 136 shkrim-

tarëve.

Persekutimi i librit!

Edhe libri është persekutuar ku në momente të ndryshme historike, dënoheshin

njerëzit që i shtypnin apo shpërndanin, shpesh bibliotekat digjeshin, apo shkatëroheshin për shkak të ndryshme. Kështu administrata osmane ka dënuar me burg shpërndarësit e revistës "Albania" Shan Shantojen dhe Kolë Troshanin. Në v. 1926, trupat ushtarake të Zogut, sipas dorëshkrimeve të At' Donat Kurtit, pas shtypjes së kryengritjes së Dukagjinit, dëmtojnë rëndë gjimnazin "Illyricum". Shkatërimi i vërtetë i bibliotekës françeskane u realizua me vendimin e 9 prillit të v. 1946, që shtetëzonte shtypshkronjën, librarinë, entet, e depove e saj si dhe bibliotekën e muzeut. Të njëjtin fat do të pësonte edhe biblioteka e jezuitëve me mbylljen e Kuvendit. Persekutim iu është bërë librave gjatë regjimit komunist, kur nuk lejoheshin të lexoheshin, ose të mbaheshin


libra me shume vlera historike, kulturore, patriotike të shumë shkrimtarëve disidentë, por as librat fetarë. Mjafton të kujtohet se vepra madhore e Padër Gjergj Fishtës "Lahuta e malcisë" është ruajtur nëpër raftet të fshehura nga shumë familje shkodrane, është lexuar në fshehtësi dhe shumë shkodranë, pa i lejuar kanë mësuar përmendësh vargjet e saj. Pavarësisht se shkodrani ka qenë admiruesi dhe fanatiku i ruajtjes së librave, ka pasur persona që e kanë shpërdoruar atë qoftë nga pakujdesia apo edhe duke e shitur për probleme ekonomike, apo edhe duke e djegur ose tretur nga frika e persekutimeve. Por ka pasur edhe të atillë filantrop që kanë falur jo vetëm libra, por edhe biblioteka të tëra, si Mustafa Pasha i fal vakëfit bibliotekën e tij, Fishta i fal bibliotekës së françeskanëve librat e përdorimit të vet; Ilo Mitkë Qafëzezi, gjurmues dhe studiues në fushën e kulturës, në v. 1937 i dhuroi Bibliotekës së Jezuitëve një pjesë të punimeve të tij, po kështu kësaj biblioteke i fal punime edhe Thimor Gjergjeviç. Familja Koliqi, mbas 1990, ia rikthen Seminarit Jezuit, librat e marrë në ruajtje. Lec Zojzi, mjek shkodran me qëndrim në SHBA, në testamentin e bërë më 1988, i deklaruar mbas vdekjes së tij, do të lejë shuma monetare, për Bibliotekën "Marin Barleti" (që u shfrytëzuan për enciklopedinë 12 vëllimshëm). Shkodrania patriotike Safet Sofia Juka do ti dhurojë Bibliotekës Kombëtare një shumë monetare të lënë më testamentin e saj për librat albanologjike. Dhurimi i librave Bibliotekës së qytetit "Marin Barleti" vijojnë edhe në ditët e sotme.

Shënim: Materiali kryesisht është bërë nga z. Gjovalin Çuni, në "Fjalor enciklopedik i hapësirës shkodrane", botuar me 2016

Prof. Dr. Zenepe Dibra

TE DEL KIRI

Nga Pal Duka-Gjini, alias,
P. Daniel Gjeçaj O. F. M.



Një libër me fjalë e frazeologji, nga burimet gojore të Lekëve të maleve, faqe pas faqesh.

Ishte vjeti ogurzi 1946.

Shi aso kohe un dola në katundin e Planit.

"Ndera e burrnia, konaku e sofrja e fisit janë porsì gjarpni, i cili porsà del nga një birë, shtjen kryet në një tjetër, tue lanë bishtin ke e para. Këso doret rrëshanësi shkon tue u bájte, derisà mos gjejë strofulin, të cilin kërkon. Motit kje thanë: Shala bukëmira. Duel sofrja nga Shala e hyni në Kir: la bishtin tek të parët e qiti kryet te na. Pushoi për do vjet këtyne stomijeve e mandej muer Kirin përpjetë. Sot në na ka mbetë bishti e kryet ka xanë vend në Plan, ku duhet të ketë gjetë pushimin e vet të dishruem".

"T" huej'n me fjalë mos ta postnoni, - bukën para por t'ia shtroni-n'Shqyptari si a' kenë zakoni".

Amanetin - thohet ndër malet tona - e

mban toka e jo ma njeriu.

- "Mirë se të ka prù Zoti e kjo natë e faqen e bardhë e paç ti që na gëzove!, qe përherë përshëndetja te praku i derës a te shtegu i oborrit. "Zoti të gëzofte me mashkuj, me gjà e bereqet e paç gjithmonë të mira prej të Lumit!" - qe urimi që miku a i hueji i la në të nisun nga trolli.

- E keqja bjen aty ku thirret, e mira, aty ku ndjellet. Në terezinë e Zotit ma randë peshon një urim i mikut, se njëqind të trueme të anmikut!

- "Një i pasun, që e ka zemrën të lidhun më të mira tokësore, jeton e punon për to e vetëm për to, tue harrue me i kthye në vizare qiellore".

- "Fshati pa shtëpinë e Zotit, asht porsì jetimi pa nanë pa babë; famullia pa mesh-tár, porsì familja pa kryetár".

- "Me dashtë të njëjtat sende; e të njëjtat sende mos me i dashtë: kjo asht miqësia e vertetë!".

- "Miku i shtëpisë si hieja e Tënzot".

- "Grueja e fisit ndo djalin ndo fjalën ta

lën".

- "Nana e mirë asht drita e shtëpisë".

- "Grueja e pushka s'hulumtohen".

- S'thotë kot kanuni se "shtëpia e mirë e keqe asht prej grave".

- Kanë pasë thanë motit: "Kurrku grue në pleqni s'á marrë, por në derë e mbrendë, këshilli i grues s'asht për t'u përbuzë".

- Thojshin këta: gjaku e gjaksori s'mund të hynë në shtëpi të Zotit pa u pastrue: kisha s'duron gjak.

- Kush i blën shejtanit vegshin, merr falë prej tij edhe kapakun.

Ka edhe të tjera fjalë e frazeologji, por po kondenhena me këto, ti mësojmë kësodore, e mandej, të tjerat, kemi rast prep.

Fundi!

Leonard Qyteza,

Shkodër me, 19 prill 2025,

e shtunde e Dritës.

A do të dinë dukagjinasi të votojnë për vete, me 11 maj?!

(Apo të këndohet refreni “Burrat Vdiqën, Rrofshin gratë”)



Në vellon e bukur demokratike të përjetësisë, kapitalizmi për të maskuar pjesët më shëmtuara të trupit dhe plagët më të pa shërueshme, zbuti sistemin shumë partiak kryesisht bipolarë dhe mekanizmin e votës, e cila përfshinë brenda të gjitha makinacionet nga më vulgaret siç ndodhë me fillestaret si ne deri tek ato më finet në vendet me demokraci borgjeze të kultivuar.

Thelbi është kudo një soji, të varfrit, punëtorë, pesimistët, studentët, të pa pune, shtresa e ultë voton për shtresën e pasur. Pra, alternohen kuajt, por qerrja mbetet e pa ndryshuar

Më 11 maj, më të varfrit e Shqipërisë do votojnë për njerëzit më të pasur dhe me të pushtetshëm të këtij vendi. Vipat kanë dalë me tupan dhe me përulje përgjyruese u bien në gjunjë atyre që i duan vetëm për një ditë, dhe që të nesërm i urrejnë, i përbuzin dhe i shkelin me patkoi ekonomikisht.

Caktimi i zonjave Bardeli dhe Koçeku ka krijuar një entuziazëm spektakolarë në radhët e bashkësisë dukagjinase, të pa përfaqësuar për më se 25 vjet. Çdo individ i bashkësisë dhe shoqëri gabon, rrëzohet, por ata që vetë korrigjohen dhe ngrihen shpejt ecin përpara, ndërsa kush gabojnë në vijimësi nuk kanë të ardhme.

Në se i kthemi historisë sonë pluralë, foshnjorë, qe braktisja e Kolë Tonajt dhe rendja pas Ali Spahisë me 1996. Zgjedhje naive pa aftësi dhe inferioritet e të majtëve qe dhurata bujare që i benë Lek Çukajt me 1997. Mos harroni se në vitin 1996 dhe 1997 Fatos Nano i dha tagër PS të Shkodrës të zgjidhe vetë baza kandidatë. Shala, Shoshi, Pulti, Postriba e Shllaku anashkaluan vetvete dhe propozuan Lekë Çukon. Postriba foli troç dhe burrërisht. Ke të propozoni ju mbështesim ne (Gjithsesi Leka “Dritë pastë” qe fort, fort hair- bam për dukagjinasin e familjes socialiste).

“Donkishotizmi”, pushtoi majat në vitin 205 kur Palë Lera u hedhe në nokdaun vetë nga dukagjinasi, për Astrit Bushatin, që nuk kishte kenë kurrë në Dukagjin.

Ka 30 vite, që nuk kam pushuar së thirruri për vetë përfaqësimin e Dukagjinit dhe as një herë për vete! Dy çikat e mira që do jenë deputete më gëzuan dhe i kam përshëndet me shumë dëshirë, por mos harroni nuk janë as njëra, zgjedhja jonë. Është një listë me 13 garues dukagjinasi të ri, të arsimuar me perspektive. E kam pritë më gëzim këtë gjeneratë të re, që po vjen!

Jam i bindur se, ata që nuk duan përfaqësimin e Dukagjinit do ta kenë shumë më vështirë të përballën me këtë armate se, sa me atë të brezit tim të djegur. Ajo që më shqetëson dhe më trembe është, pse kaq shumë lojtarë në një fushë kaq të vogël?!

A rrezikoni t'i thyeni “brirët” njeri -

tjetrit?! Rama e Berisha gjithçka mund të jenë, por jo budallenj! Aq sa kanë futur në listat e mbyllura me plus minus 1 e shumat 2 do lëvizin kandari elektoral. Në këtë muaj të nxehtë, kur secili i duket vetja mbret. Dukagjini ka një provim shumë të vështirë.

TË ZGJEDHIN CILI DO TË JETE DEPUTETIT I DALË NGA LISTA E HAPUR E PLEBENJVE

Greta e Marjana janë dhuratë nga Zotat e frontit. Ka edhe utopist Fb, që thonë se Dukagjini do të thyej rekordin olimpik, duke bekuar katër “senatorë “. Kjo është një “mrekulli” sa e bukur aq e pa mundur. Por nëse Dukagjini nuk çon të tretin e vet në Tempullin e Tiranës, atë herë duhet recituar metafora poetike e një libri tim “Burrat vdiqën, Rrofshin gratë”!

Rruga 4-5 mijë qoftë edhe për 13 garuesit nuk i vlen as gjë Dukagjinit. Në përfundimin e rrugës automobilistikë Shkodër- Dukagjin- Qafë e Agrit -Gjakovë dhe përfarimi me rrugë dytësore i Thethit me Lumin e Shalës, na intereson shumë edhe Hidrocentrali i Nën Mollës në Shosh. Na duhet një përfaqësi lotuese dorëbashkuar e gjithë deputeteve veriore për Projektin evropian të Hekurudhës madhore Shkodër - Dukagjin - Gjakove.

Na duhet çertifikim i pronave. Shikoni tituj editorial të Gazetës “Dukagjini” në vite. Dëgjojeni thirrjen zërave me të artikuluar publik si Lazer, Kodara. të ndërjet Luigj Shyti, Zef Gjeta, Lazer Stani, Ndue Sanaj, Zef Nika, Suela Ndoja, Mëhill Shkëmbi e Agron Përbiaj. Kushtrimi i Pal Skambit mbetet aktual, i cili sot nuk është ma një zë i vetëm në shkretëtirë.

Dëgjojeni edhe melosin bashkëpunues mes meje dhe Gjovalin Shanit e Pal Shkambit “Dukagjin deli Zot vetit”. Mos harroni protestën dhe peticionin e pare publik të përmasave të tilla, për mos fshirjen e Dukagjinit nga harta elektorale, madje ankesa jone flenë akoma në Gjykatën Kushtetues. Është koha kur emocioni tifozëria, duhet mbahen nën frerin e fortë të logjikës së ftohet pragmatistë të dobishme, që Dukagjini të futet si Thethi në rrugën e zhvillimit të turizmit malorë gjithë vjetore.

Prele Milani

Hekurudha Shkoder - Gjakove, një enderr, që pershkon zemren e Alpeve

Projekti i hekurudhës Shkodër - Gjakove që përshkon zemrën e Alpeve shqiptare, nuk është thjeshtë një linje transporti, por një vizion novativ. Në shpresën, që merr formë. Një investim strategjik ndër rajonal, që mbartë në vetvete një ngarkese historike kombëtare dhe evropiane.

Është ëndrra më e bukur evropiane, për Shëngjinin, Shkodrën, Dukagjinin, Malësinë e Madhe, Malësinë e Gjakovës, për Kosovën dhe krejt Shqipërinë. Një Project, që tejkalon kufijtë politik administrativ dhe që bashkon zemrat e njeri tjetrit të ndarë pa drejtësisht ndër vite. Është një hekurudhë që nuk lidhë vetëm qytet, por historitë dhe për të ardhmen tone të përbashkët.

Nga Austro - Hungarezet te Amerikanet - një ide, që nuk vdes!

Gjurma e këtij projekti ndjek hapat e një ideje të vjetër, të nisur që 110 vite më pare nga austro - hungarezet, e më vonë e përsëritur nga italianët. Fuqitë e mëdha gjithmonë kanë ditur të mendojnë në shekuj. Shqipëria modern, për hire të së vërtetës, është edhe nje produkt i interesave strategjike austro - hungareze, që kërkonin një Shqipëri etnike për të stabilizuar rajonin.

Sot, projekti amerikan për shqiptarët, është vetëm një vijim i asaj ideje të hershme dhe për mua, ky projekt është ëndrra më e bukur e jetës sime, për zhvillimin e krejt Gegnisë. Nuk e shoh si tullumbace

elektorale, sepse e tillë nuk është. Është një Project, që kërkon kohë, përkushtim dhe bashkëpunim të gjithanshëm.

Koha për bashkëpunim dhe përgjegjësi Kombëtare!

Ky projekt nuk ka ngjyrë politike. Ai duhet të bashkojë të majtë e të djathtë, qeverinë e Tiranës dhe të Prishtinës, si dhe gjithë partnerët tanë ndërkombëtare. Është koha, që i shërben për t'u bashkuar rreth një ideje, që i shërben të ardhmes. Deputetet e veriut, e më gjerë, krejt Parlamenti, duhet të kenë këtë prioritet. Nëse i duam fëmijët tanë, nëse e quajmë vetën patriot, atëherë kjo është trashëgimia më e vyer, që mund t'ua lëmë, një kryevepër inxhinierike në zemër të natyrës shqiptare.

Duhet të shpërngojmë pak rripin, për këtë mirësi të madhe. Të lëmë rapsoditë dhe fjalët boshe dhe shpatat fjalëve pa vepra. Kjo është beteja më madhe bashkues ekonomie, mbarëkombëtare - dhe as një projekt tjetër nuk ka potencial më të madh se ky.

Një dite do të ndodhe, qoftë edhe pas meje!

Do vijë dita, që Alpet do të “pushtohen” nga vizitorë, natyralist, dashamirës të jetës së qetë e udhëtarë nga gjithë Evropa. Ndoshta nuk do kemi mundësi për çdo pushues, por do kemi diell, lumenj, kodra dhe fusha, që bashkohen në një afërsi të radhë, si rrathë të një unaze të artë.

Fushata elektorale, për mua nuk ka surpriza. Fituesi këndon, humbësi qanë e nuk pranon humbjen. Shkodra duhet të shkundet nga mendësia e vjetër vetmburrëse krahinore dhe të përqafojë veprimin, praktikizmin, idealizmin dhe dashamirësinë e njerëzishme. Duhet të çlirohet nga vogëlsitë, pushtimi i trotuareve, kioskat, betonizimi pa fre. Unë besoj se kjo do të bëhet. Edhe nëse atë ditë nuk do jemi më - amanet ma sillni një shishe verë. Ta pi e të dehem në jetën e pa sosun, për ëndrrën zëbukur të jetës sime!

Prele Milani

Mjete të tilla si intriga, dyfaqësia, thashethemet, përgojimet prapa krahëve, format e ashpra të dhunës verbale, janë forma të sjelljes në “jetën moderne”



Gëzim Tushi, “Mjeshtër i Madh”

- Ja cilat janë sinjalet që ” trokasin në “derën e madhe” të shoqërisë së sotme
- Pse është kaq e intoksikuar patologjia e famës sociale?
- Ja cilët janë gjeneratorët mediatikë që intensifikojnë të keqen sociale
- Nevoja për famë sociale, një lloj “imperializmi” tipik i jetës postmoderne, një “ideologji gjithpërfshirëse” e kohës
- Me ato që shohim të mos bëjmë as të çuditur, puritanin moralist, apo konservatorin e ndryshkur, duke mohuar të vërtetën

Tani që telerealiteti spektakolar i edicionit aktual të “Big Brother Vip” është drejt fundit, është e udhës që sociologjikisht dhe etikisht të reflektojmë për të vlerësuar në përmasa serioze ndikimet sociale, disa dukuri dinamike, herë spontane e herë të koncentruara si dukuri tipike të jetës së sotme, ca gjëra që burojnë herë si patologji sociale e herë si terapi me efekte socio-psikologjike kurative. Ka një shqetësim të madh social, të cilin e ritheksoi dhe evidentoi në përmasa të hipertrofizuara ky telerealiteti, që është kristalizimi i ideologjisë së nevojës së njeriut për dukje publike, trafik influence sociale, ridimensionim i personalitetit përmes simulakrave individuale, të gjitha të konvertuara në dëshirën e shfrenuar dhe patologjike të njeriut eksentrik i dhënë tërësisht në betejën për të qenë “influencer” përmes elementëve formal të dukjes, sjelljes.

Askund tjetër nuk ka hapësirë më adekuate për simulakra sociale se sa në këtë shtëpi. Se aty më në fund gjithçka është lojë stimulimi dhe simulimi. Të

gjitha shqetësimet, dilemat, kënaqësisë, vuajtjet, trishtimi dhe konfliktualiteti janë rrethore e momentale. Herë të vërteta e herë të stisura, herë të ftohta e dredharake e hamendësime rrethore.

Nevoja për famë sociale

Nevoja për famë sociale, ky lloj “imperializmi” tipik i jetës postmoderne, kjo “ideologji gjithpërfshirëse” e kohës, e bashkuar me dëshirën për para e sukses me çdo kusht, të cilët kanë qënë komponentë ekzistenciale të këtij spektakli, në thelb janë tregues sinjifikative të kuintesencës së natyrës, së shoqërisë së sotme shqiptare. E cila i ka fare të ravijëzuara tiparet si “shoqëri e spektaklit”, e qejfit, e arritjeve, performancës dhe suksesit personal. Një galeri tiparesh tipologjike të jetës postmoderne, të cilat në mënyrë të sintetizuar u dukën qartë dhe u ravijëzuan në lidhjet dhe marrëdhëniet qarkuluese brenda këtij telerealiteti. Me siguri edhe me efekte dhe kundërefekte në jetën sociale të shoqërisë, qoftë si ndikime të drejtpërdrejta, apo të tërthorta në sjelljen, jetën e përditshme, profane të shoqërisë, në parimet konceptuale dhe ndërtimin e raporteve empirike të njerëzve tanë. Në miniaturë, nga dimensionin por në përmasa spektakolare, këto tipare të përgjithshme, që janë ravijëzuar në jetën e shoqërisë shqiptare, apo që janë në fillesat e shfaqjeve të tyre masive, i gjejmë të konturuara sociologjikisht në ambientet e këtij “teatri social”. Në mënyrë të padyshimtë, ka qënë diçka e natyrshme, e pritshme që në këtë shtëpi të vogël, në kushtet e habitatit të ngushtë dhe do kishte një “bashkekzistencë të ngjeshur” sociale të mbushur me kontradikta edhe për shkak të garës dhe rivalitetit të banorëve të saj. Sepse në një telerealitit të tillë, natyrshëm që ekzistojnë lidhje “të ngjitura” për shkak të hapësirës së ngushtë dhe kohës lineare të pakufizuar. Duke qënë në mënyrë të pandërprerë afër dhe pranë njëri tjetrit, janë të natyrshme turbullimet psikologjike e turbulencat morale, sentimentale e me propabilitet edhe ndoshta seksuale. Ne kemi parë skena të natyrave të ndryshme, madje ka patur raste kur kaosi social i lojtarëve me interesa të ndryshme, apo të kundërta, janë ekzagjeruar deri në kufijtë e të pakuptueshmes, apo të absurdit, të cilat në dimensionin e tyre janë jashtë e përtej “kufirit social” me të cilin ato shfaqen në jetën reale, midis njerëzve në familje apo shoqëri. Madje ndonjëherë konfliktet dhe stratagjemat e intrigave, manipulimeve, mjeteve të përdorura për qëllime gati jo humane e perverse, nuk na bëjnë të

mendojmë pozitivisht për atë “morfologji marrëdhënesh”, që kanë ndodhur dhe po ndodhin në këtë “shtëpi pa mure” dhe me transparencë sociale. Kur shikon kahjen, forcën e negativitetit të kësaj “cope sociale eksperimentale”, të vjen në ndihmë paradigma kafkiane e “fuqive djallëzore” që do ketë shoqëria në të ardhmen, “fuqitë djallëzore” të së cilës nuk po trokasin vetëm tek dera e “shtëpisë telereale” se sa ato mund të jenë sinjale sociale që do trokasin akoma më fort, në “derën e madhe” të shoqërisë së nesërme. Në mënyrë të

dukjes, shpesh kaotike, e përçarë apo në jo pak raste edhe moralisht e shpërpjestuar.

Lojtarët e dinë mirë, e kanë mësuar këtë “ideologji spektakolare populiste”, që para se të hynin në shtëpinë e BBV, që ata do ndahen në pëlqimet parapëlqimet apo urrejtjet e tyre të personalizuara, duke u bërë tifoz pasionant, më së shumti jo aq me aktorët e arsyeshëm, prudent, të matur, por me lojtarët që ngrenë konflikte, shumë herë artificial, dhe që shfaqen në teatrin mediatik si kundërshtarë të fortë teatralë



sintetizuar dhe në vlerësimin e integruar social të problematikave që evidentohen në BBV, qoftë si ontologji apo si fenomenologji e formave të patologjive sociale të jetës sonë të përditshme, të cilat në ecencë, pavarësisht nuancave spektakolare e simularkave mediatike, në konceptimin diagnostikues qoftë si identitet mediatik apo eksperiment social (një debat i hapur socio-filozofik), janë pasqyrim i problematikave të vërteta të shoqërisë aktuale. Një shoqëri me tendencë të akseleruara supermoderne, spektakolare, e

Të njohim të vërtetën

Të mos gënjejmë veten dhe pa rënë në pozitat e hipokrizisë sociale (një sëmundje shumë e përhapur në shoqërinë tonë, e sintetizuar në dyfaqësinë e njeriut, që akoma është reminishent me njeriun e ri të socializmit, që fliste ndryshe nga çfarë mendonte dhe mendonte ndryshe nga çfarë thoshte), duhet të njohim të vërtetën, që përtej ca ekzagjerimeve për qëllime personale afirmative apo ekseleve komunikative agresive (mbi nivelin e



tonalitetit të vërtetë social të jetës sonë), gjërat që pasqyrohen në këtë spektakël janë afërsisht “gjërat tona”, dukuri që i kemi në jetën tonë të përditshme në familje, shkollë, jetën profesionale, në marrëdhëniet sociale publike dhe ato të jetës së ngushtë miqësore apo pse jo edhe intime, të cilat “laboratori social” i BBV përmes transparences, krijoi kushte për të perfeksionuar këto mjete bashkë me artin e përdorimit më të sofistikuar të këtyre mjeteve. Askund tjetër nuk ka hapësirë më adekuate për simulakra sociale se sa në këtë shtëpi. Se aty më në fund gjithçka është lojë stimulimi dhe simulimi. Të gjitha shqetësimet, dilemat, kënaqësisë, vuajtjet, trishtimi dhe konfliktualiteti janë rrethana e momentale. Herë të vërteta e herë të stisura, herë të ftohta e dredharake e hamendësime rrethana. Në mënyrë të drejtpërdrejtë me ambientin social të kufizuar të shtëpisë BBV, apo në mënyrë diagonale me secilin nga banorët e saj, ajo shërbeu herë si habitat i përbashkët dhe herë duke evidentuar lidhjet personale. Mjete të tilla si intriga, dyfaqësia, thashethemet, përgojimet prapa krahëve, format e ashpra të dhunës verbale, gjëndjet vullkanike orale (shyqyr që nuk kemi patur dhunë fizike apo seksuale të hapur), në emër të garës, efekteve mediatiche, nevojës për famë dhe fitore natyrisht, këto dukuri që ndeshim në jetë në forma bruto e të papërpunuara, i gjejmë në këtë format televiziv më të perfeksionuara, të cilat i jepen publikut si paradigma tipike, si forma arketipale të sjelljes në “jetën moderne”.

Por aty janë të pranishme të gjitha nuancat e raporteve dialektike të jetës, qoftë sociale, apo psikologjike, mënyrave e formave të reja që përdoren për ndërtimin e marrëdhënieve midis njerëzve në garë në konkurrencë reale. Madje deri në nivelet e agresivitetit, anktheve, dyshimit, pasigurisë, që kanë sjellë pasoja edhe të sjelljeve jo normale, depresive.

Me ato që shohim...

Pra të mos bëjmë as të çuditurin, puritanin moralist, apo konservatorin e ndryshkur, duke mohuar të vërtetën, që përgjithësisht ato dukuri sociale e sjellje psiko-morale që në miniaturë i ndeshim në BBV, nuk janë ngjarje ekstra territoriale apo tipike për një shoqëri tjetër ndryshe nga e jona. Por nga ana tjetër duhet kuptuar fakti, se në një hapësirë sikurse është kjo “shtëpi” është e natyrsme që intensiteti i debateve, shkalla e konfliktit, intrigës shfaqen më me intensitet, agresivitet evident dhe kontinuitet, qoftë ky thelbësor, apo për efekte spektakolare. Lojtarët e dinë mirë, e kanë mësuar këtë “ideologji spektakolare populiste”, që para se të hynin në shtëpinë e BBV, që ata do ndahen në pëlqimet parapëlqimet apo urrejttjet e tyre të personalizuar, duke u bërë tifoz pasionant, më së shumti jo aq me aktorët e arsyeshem, prudent, të matur, por me lojtarët që ngrënë konflikte, shumë herë artificial, dhe që shfaqen në teatrin mediatic si kundërshtarë të fortë teatralë, duke u përpjekur për të ndërtuar mizanskena televizive tërheqëse, shoqëruar me “lëndë sociale” komunikative eksplozive, duke vlerësuar nivelin e atraksionit televiziv. Madje duke i parë gjërat me realizëm, këto dukuri spektakolare të trans-



platuara nga realiteti social dhe jeta reale si tipologji sjelljeje, këtu shfaqen të amplifikuara, të lidhura jo vetëm me hapësirën e ngjeshur sociale, por edhe me nevojën për performancë televizive individuale. Kjo është arsyeja pse dialogu nevrastenik dhe permanenca konfliktuale në marrëdhëniet e banorëve, janë në përmasa jo të zakonshme, kur i krahason ato me

sisteciteti, për të cilën shoqëria dhe njerëzitanë nuk kanë nevojë, sepse e kanë me bollëk në jetën e përditshme.

Jeta jonë nuk ka nevojë për “gjeneratorë shtesë”, që prodhojnë dhe intensifikojnë të keqen sociale në shoqëri.

Ka ca ngjarje, madje të shpeshta, lidhje,



sjelljen njerëzore në jetën e përditshme. Nëse qëllimi i këtij “eksperimenti social” do të ishte ky, që lidhet me sofistikimin e mjeteve jo sociale e antihumane, kjo do të ishte vërtetë një eksperiment pa substancë biofilike, që nuk do kontribuonte në përmirësimin e shëndetit të shoqërisë dhe marrëdhënieve njerëzore. Një burim tok-

marrëdhënie, konflikte, debate, aleanca konjunkturale, veprime okulte e indirekte, rivalitete, xheloz, urrejttje patologjike, e plot mekanizma të tjerë të natyrës social-psikologjike, që vërtetojnë se në kohën e sotme në marrëdhëniet njerëzore kanë ndryshuar modalitetet e lidhjeve shkakësore. Jetojmë në habitatin e shoqërisë



postmoderne, të vendosur në kornizat e një jetë likuide (të rrëshqitshme) e të paqëndrueshme, të mbushur me lëkundje thelbësore dhe pasiguri sociale ekzistenciale, në të cilën marrëdhëniet njerëzore janë gjithnjë e më pak humaniste e solidare, empatike e mëshiruese, ku narcizizmi është bërë ideologji sunduese e modul determinant për “njeriun e vetmjaftueshëm” e të sukseshëm, në të cilën lidhjet midis shkakut dhe pasojës në marrëdhëniet njerëzore kanë kapërcyer modelin e vjetër të jetës tradicionale. Këto janë bërë të vështira për t’i kuptuar dhe interpretuar si duhet në jetën e vërtetë sociale, pale pastaj kur jemi në situatë eksperimentale, ku kemi subjekte konkures, lojtarë rivalë që ndodhen të vendosur qëllimisht nën trysinë e distancës sociale minimale, dhe nën ndikimin e faktit që lidhjet shkakësore dhe ngjarjet zhvillohen para kamerave televizive, këtij “agjenti të jashtëm” që i nxit, i ashpëron, i amplifikon konfliktet duke dalë përtej dialektikës së marrëdhënieve në jetën reale.

Padyshim është një situatë simulakrimi, sepse për këdo është dilema analogjike nëse kemi të bëjmë me një botë sociale të vërtetë apo me një realitet të sajuar për efekte spektakolare të kulluara. Pavarësisht çdo imagjinatë socioalogjike individuale apo pritmërive moralistike, shtëpia e BBV është një prerje sociale, një copë nga realiteti i vërtetë, edhe pse mbase jo plotësisht i përrputhur në mënyrë adekuate. Por aty janë të pranishme të gjitha nuancat e raporteve dialektike të jetës, qoftë sociale, apo psikologjike, mënyrave e formave të reja që përdoren për ndërtimin e marrëdhënieve midis njerëzve në garë në konkurrencë reale. Madje deri në nivelet e agresivitetit, anktheve, dyshimit, pasigurisë, që kanë sjellë pasoja edhe të sjelljeve jo normale, depresive.

Skena të ashpra të konflikteve esenciale

Sa herë që shikoj skena të ashpra të konflikteve esenciale apo ekzibicionale në ambientet e “shtëpisë pa mure” në BBV, mënjëherë mendja të shkon në disa tipare të jetës së përditshme, ekzistenciale dhe endemike, si shoqëri që po bëhet gjithnjë e më shumë transparente, likuide, e sflitur, që e çon individin deri në gjëndje raskapitëse me të gjitha karakteristikat e burn-outit psikologjik. Kjo është arsyeja pse edhe loja në këtë telerealitet duket kaotike, performancat individuale i kanë të gjitha modalitetet e sjelljes sociale, që përfaqëson atë të vërtetë që është përtej kësaj “shtëpie të famshme”, që është kthyer në laborator social në të cilën banorët ndjekin me besnikëri dhe frenetizëm spikatjen dhe afirmimin e sukseshëm të zhvillimit pragmatik e personalisht të lojës. Në fund të fundit, sido që ta vëzhgojmë nga pikëpamja sociologjike, apo ta vlerësojmë me instrumenta psikologjike, jemi dhe jetojmë në një shoqëri likuide (Zygmunt Bauman), turbokapitaliste, e shpejtësisë dhe ndryshimeve të befasishme, që nuk është koherente, me “konstante etike” të qëndrueshme apo me struktura institucionale dhe amortizatorë socialë të stabilizuar.

Historia e ndërtimit të rrugës së Komanit nga ushtria shqiptare e rikonstruksioni i saj nga KESH

Rruga e Komanit është rrugë që lidhe dy hidrocentralet Vau Dejës dhe Koman. Gjate gjithë jetës time në gazetari së bashku me koleget e mi kam trajtuar qindra probleme të gjendjes së mjerueme të kësaj rrugë automobilistike.

Kjo rrugë filloi së ndërtuari në vitin 1978 dhe përfundoi në vitin 1980. Fillimisht është ulur nga Qerreti i Pukës një traktor nga Jak Nika, i cili ishte nga Komani, udhëtimi i të cilit zgjati tre dite deri në lagjen Gogsh, të Komanit, dhe nga Vau i Dejës kane ardhur dy kompani të ushtrisë Shqiptare, nga Njësia me qendër në këtë rajon.

Puna ka nis nga Komani dhe njëkohësisht në Qaf Laç nga reparti ushtarak. Siç kujton sot oficeri pensionist Shefqet Hykaj, për punën e madhe kolosale të kryer në atë kohë. Usharet ishin vendosur në pjesë të rrafshëta, ku kishte burime uji dhe ishte kthyer në kantier ndërtimi. Për hapjen e kësaj rrugë janë angazhuar rreth 1000 vete, ushtaret, rezervistet e vullnetare nga gjithë Shqipëria, për tre vjet. Rruga është hapur me mjete primi-



tive, lende plasëse, dinamit, traktorë dhe reportable, makina vetëshkarkuese. Inxhinieret e projektuesit kishin planifikuar manipulimin e këtij terreni malor me shumë kthesa dhe e vështirë për tu arritur ta bëjnë funksional me minimum financiar. Është derdhur djerse e madhe, duke punuar pa pagese.

Pastaj për tre dekada nuk është bërë

asnjë shërbim përveç ndërtimit të një ure mbi lumin e Gomsiqes. Kjo rrugë me standarde të dobëta dhe potencial rrezikshmërie sidomos për shembje ka sjelle rreziqe të mëdha vit pas viti deri që udhëtarët filluan ta braktisin dhe të udhëtojnë vitet e fundit neper territorin e Kosovës, për të mbërritur në Tropoje dhe në zonat përreth.

Muaji mars ka hapur dritën jeshile, që fal deputeteve të Shkodrës të vitit 2021 dhe iniciativës së Kryetarit të Bashkas Shkodër, z. Benet Beci, ish drejtues i KE SH (Korporatës Elektroenergetike Shqiptare), e cila është financuesja e rikonstruksionit të plote prej 40 km nga Qafa Laçi për në Komani.

Për banoret e Shkodrës, Pukës, Tropojës e Kosovës do të sjelle ndryshime të mëdha, gjithashtu edhe për zhvillimin e turizmit në ato zona dhe që do të përmirësohet niveli i jetesës së banoreve të tyre.

Puna sapo ka filluar nga Komani për 10 Km e para. Një ëndërr kjo, që më në fund po bëhet realitet për të gjithë ata banorë të brigjeve të Drinit.

Përfitoj nga ky rast ti falënderoj personalisht për këtë nismë dhe shpresoj ta arrijnë deri në fund këtë projekt të shumëpritur dhe jo vetëm nga unë!

Përgatiti:
Zef Nika, Bruksel

Futbolli shkodran në zi!

Ndahet nga jeta Paulin Ndoja, legjenda e portës shkodrane!

Paulin Ndoja është një nga figurat më të shquara në historinë e futbollit shqiptar dhe veçanërisht në klubin "Vllaznia" të Shkodrës.

Paulini ka lindur në qytetin e Shkodrës, me 19 dhjetor 1945. Në moshë të re nis të merret me futboll, duke spikatur menjëherë. 20 vjeçar fiton Kupën e Shqipërisë, me ekipin e "Vllaznisë", pikërisht në vitin 1965. Më pas e dërgojnë ushtar, në rrethin e Skraparit dhe rikthehet serish në Shkodër për të dhënë kontributin e tij në fitimin e titullit kampion dhe Kupës së Shqipërisë në sezonin 1971 - 1972.

Një vit me vonë do ta largonin nga futbollit për arsye biografike. Pas përfundimit të karrierës si lojtar, Paulin Ndoja ka vazhduar të kontribuojë në futbollin shqiptar si trajner dhe përgatitës i portierëve në Akademinë e "Vllaznisë".

Përkushtimi i tij ndaj klubit dhe futbollit shkodran ka qenë i pandërprerë, duke ndihmuar në zhvillimin e talenteve të reja dhe në ruajtjen e traditës së pasur të klubit.

Në vitin 2019, në nder të kontributit të tij dhe të Selami Danit, u organizua Kupa "Selami Dani dhe Paulin Ndoja", një turne për moshat e reja që përfshiu 41 ekipe nga Shkodra dhe Lezha.

Kjo veprimtari u zhvillua nga Federata Shqiptare e Futbollit në bashkëpunim me klubin e futbollit "Vllaznia", duke treguar respektin dhe vlerësimin për figurat historike të klubit. Paulin Ndoja është gjithashtu i njohur për deklaratën e tij të njohur: "Vllaznia është jeta ime", duke shprehur lidhjen e thellë emocionale me klubin dhe qytetin e Shkodrës.



Me 29 mars 2025 mbushen 100 vjet, që ra heroikisht I Heroit të Popullit, Bajram Curri

"Udhëtimi" i fundit i Bajram Currit: Dragobi - Kolgecaj - Zogaj - Krumë..."
(Kujtime të bashkëkohësit, Ukë Arif Ahmeti)

1 - Babai im, Ukë Arif Ahmeti - Hajdarmataj, në moshën 96 vjeçare, që në rini më pat treguar episode të ndryshme për traditat atdhetare e luftarake të të parëve tanë. Sidomos i kam dëgjuar me interes dhe i kam regjistruar në kujtesë ngjarjet e tij rreth figures së ndritur të "Plakut të maleve" dhe "Dragoit të Dragobisë", Bajram Curri, Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit.

Është krenari për të gjithë ne, që me emrin e tij, është pagëzuar qyteti i bukur alpin, i cili më parë quhej fshati Kolgecaj.

Arif Ahmet Hajdarmataj, gjyshi im, kishte lindur në fshatin e bukur Zogaj të Malësisë së Gjakovës (Tropojë) në vitin 1843 dhe vdiq po aty, në moshën 102-vjeçare. Shtëpia e tij dhe e kushërinjve tanë kanë qenë bazë e sigurtë për strehimin e Bajram Currit, me luftëtarët e tij, sa herë që atyre u paraqitej nevoja. Po kështu ata morën pjesë në betejat e zhvilluara me udhëheqës Bajram Currin në tërë krahinën e Bytyçit e më gjerë, si në Zogaj, Kam, Qafë Prushi, Krumë e Gjakovë. Për këtë arsye vetë Arifi, është arrestuar e gjykuar në Prishtinë, ku e kanë dënuar me 101 vjet burg. Aty i vuajti disa vite burgim dhe doli prej andej vetëm kur burgu i Prishtinës u thyje nga demonstruesit kosovarë. Më pas ai erdhi në vendlindje, pranë fshatit Zogaj.



Me 29 mars 2025 mbushen 100 vjet, që ka ra heroikisht Heroi i Popullit, Bajram Curri

U organizue Akademi përkujtimore për Bajram Currin, në Akademinë e Shkencave, në Tiranë, me pjesëmarrës intelektual të ardhur nga Kosova, Tropoja, Kukësi, Hasi, Puka, Shkodra, Tirana, Vlora si dhe mbesa e Bajram Currit, Mimoza Kraja, Albion e Fatmir Curri dhe deputeti i Kuvendit Popullor Eduart Shalsi.

U mbajtën ligjerata nga Prof. Dr. Bernard Zotaj - Mjeshtër i Madh, Prof. Dr. Bardhosh Gaçe - Akademik, Prof. Dr. Pëllumb Xhufi, Prof. Dr. Zaho Golemi dhe të tjerë.

Dr. Mark Palnikaj autori i librit "Bajram Curri" u shpreh:

"- Ju falenderoj për ardhjen tuaj në këtë akademi përkujtimore për 100 vjetorin e vrasjes së Bajram Currit dhe në promovimin e librit tim, për origjinën dhe familjen e tij.

Deri më sot, historiografia jonë në Shqipëri dhe Kosovë nuk e ka thënë ende fjalën e sajë të fundit për kontributin e familjes Curri në historiografinë tonë dhe për rolin e Bajram Currit në lëvizjen për çlirimin kombëtar dhe përparim shoqëror.

Të gjitha librat e shkruara deri më sot nuk e japin të plotë informacionin për këtë problem. Ky libër, që po promovojmë sot, hedh dritë mbi disa të dhëna deri tash të panjohura rreth familjes Curri dhe vetë



Bajram Currit.

Gjatë këtyre 100 vjetëve, me rastin e përvjetorëve janë mbajtur shumë ligjerata, për figurën e Bajram Currit dhe janë shkruar shumë artikuj, janë përgatitur shumë emisione televizive e të tjera. Secili nga këto publikime ka rëndësinë e vet.

Në rastin e Bajram Currit, faktori që e ka përcaktuar qëndrimin e tij ndaj atdheut ka qenë: "Qëndrim i palëkundur kundër pushtuesit turk dhe qëndrimi pa kompromis ndaj pushtimit serb të Kosovës dhe të trojeve të tjera shqiptare". Për këtë as kundërshtarët më të ashpër të tij nuk kanë gjetur fakte për të vërtetuar të kundërtën, por mundohen me forma të tjera për të hedhur ndonjë grusht baltë mbi këtë fig-

urë të ndritur të kombit shqiptar.

Populli i Kosovës dhe i Malsisë së Gjakovës, por edhe i Lumës dhe i disa krahinave të tjera, e kanë provuar në kurriz dhunën dhe pabesitë e shtetit serb dhe janë shumë të ndjeshëm ndaj kësaj dhune. Bajram Curri, është në mendësinë e këtyre banorëve kampioni i njeriut që i ka qëndruar besnik kësaj kauze dhe nuk lejonte askënd që ta cenojnë figurën e tij. Populli i Kosovës dhe i Malsisë së Gjakovës në këngët e popullit e ka skalitur shumë qartë portretin e Bajram Currit dhe të kundërshtarëve të tij, duke ju treguar vendin të dyja palëve.

Në familjen Curri nuk është vetëm Bajrami ai që ka punuar për interesat kom-

bëtare, por kontributi i kësaj familje filon me gjyshin e tij, Hysen Kurti, vijon me babain e tij, Shaqir Curri, me nipin e tij, Hysni Curri dhe me kushërinjtë e tij si Shaqiri i Ri dhe të tjerët, që janë pa përjashtim kontributorë të bashkimit të Kosovës me Shqipërinë. Nuk janë shumë familje në Malsinë e Gjakovës, që të ju kenë kënduar këngë katër brezave për veprime patriotike si familja Curri.

Falenderoj Akademitë e Shkencave në Shqipëri dhe në Kosovë, të cilat kanë planifikuar në muajin tetor të vitit 2025 mbajtjen e një simpoziumi shkencor, me tema të përgatitura nga anëtarë dhe bashkpunëtor të këtyre dy akademive me objekt "Jetën dhe Veprën e Bajram Currit". Në atë simpozium besoj se do të paraqitem edhe unë me një studim të kryer për këtë temë sipas kërkesave të programit të hartuar nga komisioni organizator.

Këtë e konsideroj një veprim në drejtimin e duhur dhe besoj që temat do të publikohen mbas simpoziumit në një libër të botuar zyrtarisht me emrin e të dy akademive".

Verimtaria u ndoq me interesim dhe u vlerësue i suksesshëm nga të pranishmit.

IBRAHIM HAJDARMATAJ

2 - Siç është e njohur, në dimrin e ashpër 1925, kryetrimin Bajram Curri, i cili kishte dhënë aq shumë, me punën dhe luftën e tij të vendosur e të pandërprerë për Kosovën e Shqipërinë, e rrethuan në Shpellën e Dragobisë. Ishte pikërisht data 29 mars e atij viti, kur pas një qëndrese heroike, ai u vetëvra, për të mos u dorëzuar i gjallë në duart e kundërshtarëve të tij zogistë. Por gjithashtu, një këngë popullore dëshmon dhe bashkëkohës tregojnë, se është e njohur edhe mundësia që atë e prenë në besë, duke krijuar kushtet që kundërshtarët e tij ta vrisnin atë lehtësisht!?

Lajmi i vrasjes së Bajram Begit, siç e quanin malësorët me respekt të veçantë, u përhap kudo, siç thonë, ishte "më i idhtë se zana". Ai mbërriti edhe në Zogaj dhe në familjen e Arif Hajdarmataj, kryefamiljar i asaj kohe, si dhe e mbuloi në zi tërë fshatin. Pas vrasjes, trupin e Bajram Currit e zbritën nëpër Grykën e Dragobisë, në Shoshan, Margegaj dhe e lanë, pak kohë, në fshatin Kolgecaj, të Malësisë së Gjakovës (Tropojë) Pastaj, atë e hipën në një kalë dhe e nisën, udhës për në Krumë të Hasit, ku ishte qendra e Nënprefekurës.

Kur trupi i Bajram Currit dhe shoqëruesit e tij mbërritën në Zogaj, aty u bë një ndalesë e paparashikuar, madje e detyruar. I pari u doli atyre përpara Arif Ahmet Hajdarmataj bashkë me Zmajl Zymerin, Rexhep Alinë, Ajdin Zenelin, Bajram Hoxhën e ndonjë tjetër. Sakaq shkëmbyen fjalë paksa të ashpra, me shoqëruesit e të ndjerit Bajram Curri.

A na la Begi-a? - iu drejtua atyre Arifi. Po, na la, Arifi! - u përgjigjën ata njëzëri. Pra, vdiq dhe "Ora e Malësisë së Gjakovës", shtoi Arifi, me zë të lartë.

Ashtu është, Arif... Madje, Ora e Malësisë së Gjakovës, Kosovës e mbarë Shqipërisë, u përgjigjën disa të posaardhur...



Familja e Bajram Currit, Hajrija, vajza

Atëherë, ku po e çoni ju trupin e Begit tonë? - iu drejtua atyre me zë kumbues.

Për në Krumë, kështu kemi vendosur, u përgjigjën shoqëruesit e tij.

Pse kështu, bre burra! A doni me na koritë tërë Malësinë e Gjakovës-a? - foli i vendour Arifi.

Nuk paska tokë sa për ta shti në varr Begin, pa e dërguar atje-a?

Pastaj shtoi i vendosur: - Unë dëshiroj

që ta varrosim në tokën time, pra këtu në Zogaj. Tokë kam mjaft e nuk më dhimbset aspak. Kështu do të jemi të gjithë si fshat, të nderuar që ta mbajmë këtu Bajram Currin tonë...

Trupin e pajetë të Bajram Currit, Arif Hajdarmataj, me bashkëfshatarët e Zoga-

u rreshtua partizan në radhët e Brigadës XXV Sulmuese, e cila u krijua në Malësinë e Gjakovës (Tropojë).

3 - Në mbyllje të këtyre kujtimeve, më duket me interes të tregoj edhe diçka tjetër...

Në muajin tetor 1962, në qytetin e Shkodrës zbriti nga Zogajt, Hyrë Islam Hajdarmataj, bashkëshorte e Arif Ahmet Hajdarmataj.

Ky kishte 10 vajza dhe vetëm 1 djalë, Ukën, babain tim, të cilit i la trashëgim disa hektarë tokë, bagëti e bletë. Në atë udhëtim, gjyshja Hyrë vinte që të më takonte mua, nipin, pasi ndiqja shkollën pedagogjike për mësues. Kur ajo shkoi te Hoteli "Adriatik", mësoi se sportelistja ishte bija e vogël e Bajram Currit. Pra, Hajria. Kështu, të dyja u përfaquan me përzemërsi. Hajria i tregoi asaj se i iati i fliste vijimisht për mikpritjen e mjaft malësorëve, pra dhe atyre të fshatit Zogaj, ku veçonte pikërisht shtëpinë e mikes, Hyrës, me bashkshort Arif Hajdarmatajn.

E mallëngjyer Hyria iu drejtua Hajries: "Po gëzohem sikur të më kishte lindë një djalë, që u njohëm sonte bashkë dhe që je çika e Begit tonë të paharruem...! Ndësa Hajria e përqafoi si nënën e saj dhe iu përgjigj: "Sonte nuk ka hotel për ty...!"

Sapo e mbaroi punën e asaj mbrëmjeje aty ku shërbente, Hajria e mori Hyrën në shtëpinë e saj bujare.

IBRAHIM HAJDARMATAJ

jve e shoqëruan me sy, me dhimbje e lotë, derisa ata u larguan për në Krumë të Hasit...

Për meritat e tij luftarake dhe mbështetjen që i ka dhënë Bajram Currit gjatë jetës së tij, Presidenti i Republikë së Shqipërisë e ka dekoruar Arif Hajdarmatajn, me medalje e urdhra të ndryshëm. Traditën e tij luftarake e vijoi edhe djali i tij e babai im, Ukë Arif Hajdarmataj. Ky

Rrugëtim në thesaret e poetikes filozofike të Diamanta Zaltas

Vështrim për librin me poezi "Destinat vijnë pa zhurmë" të poetes Diamanta Zalta - pjesë nga dorëshkrimi im "Përsiatje dhe shllime letrare"

"Përkulem mbi qetësinë që sjell një libër,/mbulohem në një heshtje të pafjalë .../ Krijuar për të qënë hyjnore është heshtja,/ ndodh të ketë zë e shpirt të madh,/ zbut turbullimet, pendasat, këngët/ për të zbritur tek zhurmat e botës/ Koha, ende i buzëqesh pemishtes sime/ Të kujtoj, dhe ngaj me dy sy të ndaluar,/ mbi një libër të shenjtë, mbetur në faqen e lënë .../ Por era i lëviz zhurmat, orët, datat/ ja numëron njeriut dëshirat e fshehta,/ që janë dhe më të paktat. /Fluturat në dritë, lumturojnë për një kohë të caktuar: Nëse shpirti është fushë e lulëzuar" (Poezia "THE BRIGDES OF SILENCE", autore Diamanta Zalta)

Tiranaska Diamanta Zalta, me banim në Athinë të Greqisë, është një poete "sui generis", mjaft e spikatur, e cila me botimet e saj librorë "Ringjallja e pulëbardhave", "Rrugicave të ndjenjës" dhe "Pranvera binjake" ka shkaktuar një jehonë të thellë te auditori lexues dhe te kritika letrare. Ajo tashmë ka përfunduar së shkruari librin e saj të nëntë dhe aktualisht ka gati për botim dhe katër përmbledhje të tjera me poezi dhe kritikë e vështrime letrare.

Sa për dijeni, Diamanta ka diplomuar në disa drejtime shkencore në Universitetin e Tiranës: në Fakultetin e Shkencave Juridike, në Ekonomi Agrare e Financë, si dhe në Interior Designer në IEK Athens (Atinë).

Këtë mëngjes u enda po sikur bletët lule më lule në poetikën e poetes së talentuar Diamanta Zalta, konkretisht në dorëshkrimin e saj në botim e sipër me titull "Destinat vijnë pa zhurmë". I kam lexuar dhe shijuar thellë poezitë e saj perla: "Në varrezat e prindërve", "Bota dhe dashuria", "Shtërngata ka heshtur", "Zemra", "Të pakthyeshmë", "If", "Është", "Trupit të dashurisë", "Ekziston", "Të vetmuarit e një qyteti", "Monolog me heshtjen time", "The brigdes of silence", "Përtej xhamit je", "Fjalët", "Ah, supet", "Gjëndje", "Ç'jam unë", "Stuhi drite", "Sumbulla qetësie", "Melankoli", "Drita", "Pa emër", "Amorfe", "Dritim", "Martesë stinësh", "Me fjalën kam bërë pakt", "Dialogu i erës dhe detit", "Belbëzimeve të natës", "Vonë", "Dy të afërta", "Nga të gjyshit", "Sytë", "Trashëgimia", "Teh drite", "Pa sy dhe pa fytyrë", "Mëvetësi", "STEVEN L", "Mundim i varfër", "Ka shpëtim", "Emblemë", "Kush tha", "Betim", "Hartë", "Nga përvojat e mia", "Barazim", "Konkurenca", "Kush je ti në dritë", "Përvjetor me pemën kozmike", "Premtim i çuditshëm", "Pa gjini", "Lartësi", "Ofelia dhe Euridika", "Nënshkrim në ëndërr", "Fjala", "Perëndim", "Eja nënë", "Cak i vështirë" etj.

Derisa lexoja librin qesh i "detyruar" të zbrërthet kodet, simbolet, metaforat e frazeologjizmat filozofike të shumë poezive të këtij libri.

Një romantizëm i paparë i lirikës së

tyre të dashurisë dhe një filozofi e thellë botëvështrimore mbi njeriun dhe botën është "derdhur" aq bukur në këtë libër, "pa zhurmë" por me shumë art e dritësim, sa të gjithë yjet e qiellit të mbledhura bashkë!

Poezia e Diamantës është, siç shprehet ajo te poezia me titull "Është": "E mbështjellë me buzëqeshjen e arsyes,/ e Botës,Jetës, por është!/ Fshehur nën buzë ,sy ,gjallesa,/lind nga e vërteta./ Është drita e fshehur në xixën e syrit të heshtjes./ që pa e kuptuar shpërthen gëzimin e mendjes./ Fole në thellësitë e gjoksit të ndershëm,/ të thënash pa fjalë dhe lotit të zemrës./ Është grumbull xixëllonjash në errësirë/ udhë, ide, dhimbje, pëshpërimë/ fijeqëndisur me mend"

Pothuaj që të gjitha poezitë e këtij libri,



për shijen dhe mendimin tim, ishin perla, por perlat më të rralla, të vargëzuara me një hermeneutikë filozofike e kuptimësish të thella ishin perlat me titujt: "Bota dhe dashuria", "Cak i vështirë", "Në metronë e Athinës", "Monolog me heshtjen time", "If" dhe "Të vetmuarit e një qyteti".

E, bota perceptuese dhe zemra plot emocione e Diamantës janë sa të mëdha aq edhe racionale e filozofike. Këtë koncept botëvështrimor ajo e shpërfaq më së miri te poezia "Zemra", përmes së cilës penetron thellë në misteret e botës vetanake, duke zbuluar "të vërtetën". Po e rishijoj dhe tani këtë perlë mjaft domethënëse:

"E panjohura, e papritura, e paditura , është zemra./ Kur një hapësirë e shpirtit mbetet bosh,/ ajo strehon më tepër se një sekret./ Vetëm zemra mundet ta shohë,/ vetëm zemra mundet ta prekë .../ E vetmja që kupton, ç'është e vërtetë!"

Kurse muza e saj poetike shndrit si dielli plot nur te poezia "If":

"Në se një ditë do të ulesha,/ mbi një fletë ditari , shkruar vitesh,/Do të filloja të mblidhja copat e vetes,/ të ndërtoja me to më të bukurën strehë ,

jo nga të tjerë/ por vetë, që të ish'e vërtetë./ Do të të kërkjoja të më duash më shumë ti, e mërguar muzash/ jam edhe artisti,/ që aq shumë mban fshehur në gj.../ Rëzohem shqopave të thara/ e shpirtin me të zogut cicërimë e lëmoj,/ mbi një urë/ lutem për një Paqe me Krijuesin,/ të kem jo ç' dua , por çfarë meritoj/ Nata më mbulon me mellan/ Durimi me gurë,/ Muza me nur"

Siç dijmë, poezia është një mënyrë e veçantë e organizimit të ligjërit, që na jep marrëdhënien vetjake estetike të individit ndaj njeriut, shoqërisë, natyrës e botës.

Dihet se në antikitet shumë filozofë i kanë shkruar traktatet e tyre në formë poetike, me vargje.

pikërisht, lirika filozofike e cila shquhet për shkallën e lartë të meditimit, ajo përgjithëson në mënyrë figurative dhe nëpërmjet të mendimit të figurshëm dhe ndjenjës së figurshme ajo i krijon lexuesit asociacione emocionale, kuptimore.

Lirika filozofike nuk nxjerr konkluzione. Në të vërtetë ajo e nxit vetë lexuesin të marrë pjesë vetë në zbulimin e së vërtetës. Rolin kryesor në këtë raport "poet-lexues", "tekst-lexues" e luan shkalla sa më e lartë e ligjërit lirik poetik. Poezia, në thelb, s'ka të bëjë aspak me jetën e zakonshme të përditshme, por me dukuri të misterhme të natyrës dhe të fatit njerëzor. Kemi të bëjmë me tema filozofike.

Mandej, poezia nuk merret aspak me shprehimin dhe ligjshmërinë e tyre. Objekti i poezisë është përshkrimi i figurshëm, rikrijimi dhe jo shprehimi i kësaj tabllaje të kësaj nate të stuhishme, as të fatit të varkës, të jetës njerëzore, lumturisë e tragjizmit të saj.

Këtë botë, poezia e Diamanta Zaltas e arrin nëpërmjet figuracionit artistik, nëpërmjet epitetëve të ndryshme, midis krahasimit të "oqeanit" dhe "ëndrrave" si edhe të paralelizmit midis stuhisë së tërbuar dhe fatalitetit njerëzor.

Pra kemi të bëjmë me emocione dhe aspak me deduksione shkencore.

Poezia filozofike realizon kështu, në mënyrë sinkretiste, sintezën midis filozofisë dhe poezisë. Studjuesit e ndryshëm pohojnë se shfaqja e lirikës filozofike mundësoi lindjen e një krijimi me një botëkuptim të ri në nivelin bashkëkohor, ku volumi i kulturës së grumbulluar luan një rol të madh, hap horizonte të reja edhe për krijimtarinë artistike. Ata theksojnë se lirika filozofike nuk luan vetëm një rol gnoseologjik. Ajo ka një shkallë më të veçantë bashkëveprimi me botën. Këtë bashkëveprim e unicitet e ka realizuar më së miri në këtë libër me poezi Diamanta nëpërmjet nivelit fin artistik, duke krijuar një bashkëveprim sinkronizues të ideve filozofike me mjetet artistike letrare.

Filozofi gjerman Martin Haiddgger Filozofinë dhe Poezinë i ka quajtur motra binjake, duke nënvizuar: "Filozofia dhe poezia qëndrojnë në lartësi të ndryshme, por flasin për të njëjtën gjë". Kurse poeti dhe teoricieni i artit G. E. Lessing ka një sentencë kuptimplote të figurshme: "Filozofi, që kërkon të ngjitet në Parnas dhe Poeti që kërkon të zbrësë në luginën e mençurisë, seriozë dhe të qetë, takohen në mes të rrugës, ku ata, mund të themi, ndërrojnë veshjet dhe kthehen mbrapsht. Secili sjell në strehën e vet shëmbëlltyrën e tjetrit dhe jo vetëm kaq. Poeti bëhet poet fillozof, kurse mendimtari bëhet i mençur poetikisht ..."

Të vërtetat e ekzistencës së botës poeti i zotëron nëpërmjet vrullit krijues, frymëzimit, që varet nga aftësia dhe dhuntia, shkalla e talentit.

Sipas Josif Brodskit, është frymëzimi poetik, i cili e përshpejton ndërgjegjen, mendimin dhe botëkuptimin nëpërmjet gjuhës poetike dhe prozodisë. Është,

jet gjuhës poetike dhe prozodisë. Është, pikërisht, lirika filozofike e cila shquhet për shkallën e lartë të meditim, ajo përgjithëson në mënyrë figurative.

Nëpërmjet të mendimit të figurshëm dhe ndjenjës së figurshme ajo i krijon lexuesit asociacione emocionale, kuptimore.

Lirika filozofike nuk nxjerr konkluzione. Në fakt, ajo e nxit vetë lexuesin të marrë pjesë vetë në zbulimin e së vërtetës. Rolin kryesor në këtë raport "poet-lexues", "tekst-lexues" e luan shkalla sa më e lartë e ligjërimt lirik.

Poezia s'ka të bëjë aspak me jetën e zakonshme të përditshme, por me dukuri të mistershme të natyrës dhe të fatit njerëzor. Kemi të bëjmë me tema filozofike.

Poezia nuk merret aspak me shprehimin dhe ligjshmërinë e tyre. Objekti i poezisë është përshkrimi i figurshëm, rikrijimi dhe jo shprehimi i kësaj tabloje të kësaj nate të stuhishme, as të fatit të varkës, të jetës njerëzore, tragizmi i saj.

Këtë poezi e arrin nëpërmjet figuracionit artistik, nëpërmjet epiteteve të ndryshme, midis krahasimit të "oqeanit" dhe "ëndrrave" si edhe të paralelizmit midis stuhisë së tërbuar dhe fatalitetit njerëzor.

Pra kemi të bëjmë me emocione dhe aspak me deduksione shkencore.

Poezia filozofike realizon kështu sintezën midis filozofisë dhe poezisë.

Studjuesit e ndryshëm pohojnë se shfaqja e lirikës filozofike mundësoi lindjen e një krijimi me një botëkuptim të ri në nivelin bashkëkohor, ku volumi i kulturës së grumbulluar luan një rol të madh, hap horizonte të reja edhe për krijimtari në artistike.

Ata, madje, theksojnë se lirika filozofike nuk luan vetëm një rol gnoseologjik. Ajo ka një shkallë më të veçantë bashkëveprimi me botën. Ky bashkëveprim realizohet nëpërmjet nivelit artistik duke krijuar një bashkëveprim të ideve filozofike me mjetet artistike.

Secili sjell në strehën e vet shembëlltyrën e tjetrit dhe jo vetëm kaq. Poeti bëhet poet filozof, kurse mendimtari bëhet i mençur poetikisht.

Lexon njeriu opusin letrar poetik të Diamantës dhe të ravijëzohet figura e saj, ose, thënë më saktë, filozofia e saj poetike, në të gjitha dimensionet e saj artistike e njerëzore. Befas të ringjallet njeriu i dikurshëm! Syri e muza e artistes / poetes ka fiksuar çaste, dukuri e peizazhe të natyrës e univetsit në interpretimet e saj mjeshtërore poetike, me një vlerë sa emocionale aq edhe racionale të sintezës së metaforave më fine estetiko-letrare, e cila është një ekscesion dhe diskurs brilant në krijimin e perlave artistike, me mjete shprehëse që zbulojnë natyrshëm vullkanizimin e shpirtit njerëzor dhe të botëvështrimit të kësaj poeteje të talentuar të poetes.

Kemi të bëjmë me atë trajektore dhe transformim të qenies e të gjendjes që realizon kjo poete, e lindur si e tillë, me talentin embrional të originalitetit vetjak krijues. Me një vizion sa dritëndezës plot magji po aq edhe rrëqethës plot drithërimë, herë-herë të shpërfaqura edhe me një gjuhë plot dtamaticitet e mizerabilitet, me jetën "grubo" e herë edhe me ca shtigje të ndritshme poezie, me forcën e natyrshmërinë që ka arti sublim letrar -




poezia si mbretëreshë e artit.

Poetja Diamanta Zallti veçmë ka kohë e kohë që po skalit mrekullueshëm kredon e vet cilësore letrare kundër shablloneve të uniformitetit, kundër trajtës lineare, statike (pa gjak e shpirt) e të ngurtësuar të shprehjes poetike, shpesh edhe me një digresion e retrospektivë të brendshme,

zantim autentik i biografisë së tij krijuese".

Dhe këtë portret e biografi kreatoriale e shpërfaq më së miri edhe artistja e poetja Diamanta Zallta në poezinë e saj perlë me titull "Ç'JAM UNË?", teksa vargëzon krenarisht:

"Edhe sikur zemrën të ma shkulin , sikur të ma shqyenin cipën e shpirtit ,



për ta bërë zhvillimin e artit poetik sa më dinamik, me një botë të pasur shpirtërore, gjithmonë nën ritmikën e natyrshmërisë. Për më tepër, në çdo poezi ajo kërkon "syrin njerëzor" në portret, në kuadër, në peizazhet e natyrës që i fikson dhe në imazhet e mëpërtejme të sykapjes së vlerave të përbotshme... Këtë ajo e shpërfaq me një gjuhë kulminante shprehëse, e cila të magjeps dhe e cila jo pak herë ngrihet si mbivlerë estetike plot sharm letrar.

Zakonisht, në "arkeologjinë" e mistereve të artit, pikturës, poezisë e prozës, thuhet qartë një sentencë primordiale: "Portreti i krijësave të artistit është

zjarrin të më vinin e të kthehesha në hi, përmbi hi prapë do të mbinin , Lulepoezi !"

Dhe te poezia tjetër me titull "NGA TEPËR PERSONALET", ajo i vargëzon botës së saj poetike - poezisë:

"Ashtu si një guackë, mban me fanatizëm brënda vetes tingujt e detit,

Ashtu të mbaj unë ty, Poezi, brënda shpirtit"

Kurse botëvështrimin e saj tejet racionale e filozofik, si synimin më ideal të jetës, autorja e shpërfaq te poezia me titull "ÇAK I VËSHTIRË", teksa vargëzon me shumë

sens: "Se caku më i vështirë i jetës, / është ai kur harrohet shpirti./ Kjo mbrëmje është varur e gjitha në ajër,/ në shi , si një pikturë akuareli.../ Syri kaplon drurët e xhveshur përtej xhamit,/ brënda murit gjen varur portrete të zverdhur,/ ca libra të vjetër qëndrojnë rradhë në etazher,/ si pleq të mençur , të heshtur.

Dëshmitarë të denjë,/ kohësh të brejtura,

ca me fletë të kthyer e ca të hequra. / Por mua më dhëmb më shumë se gjithçka,/ peisazhi i zemrës,/ që vidhet nga unë e bën sikur shkëlqen. / Unë e di , se po të fus dorën aty brenda shpirtit,/ diçka zhbëhet e më zhbën.../ Ç'të jetë dhe kjo dritë Perëndie ,/ që u pengua sapo mbi mua rrëshqiti./ Sa cak i vështirë qënka, sa cak i vështirë .../ Ai kur harrohet shpirti!"

Po kaq filozofi të thellë autorja shpërfaq edhe te poezia me titull "BOTA DHE DASHURIA", teksa vargëzon qëllimin final të të ekzistuarit - të vetë jetës së njeriit në këtë botë relative:

"Sa e vjetër kjo botë,/ në kërkim të lumturisë,/ ngujuar si plaçentë splaknave të dashurisë,/ me atë ngjyrë të përhimtë pendesash, ndërgegjesh,/ pengje lënë pas,/ në destina Perëndish.../Në dashuri, Dinjiteti bëhet më i epërm./ Asnjë shpresë për të qënë tolerant./Ylberet këmbehen me stuhi edhe kur e kuja përflaket,/në nyje kryqëzimesh është i Parë , mbi jetën edhe fatet/ Sa një varkë e vogël Liria,/ bashkë me rremat që kërkojnë të zgjaten./ Dëshira Hyjnish drejtojnë të padukshmet,/ nga Drita më e pakët, të kapen/ Sa e thjeshtë, të duash!/ Madhështore, ta kuptosh e ta ruash!"

Duke qënë se jeton e vepron në Athinë, Diamanta e dekonspiron dashurinë e saj të zjarrtë ndaj këtij metropoli grek në poezinë me titull "NË METRONË E ATHINËS", teksa vargëzon me pasion e filozofi të thellë njëkohësisht:

Në rrugën e fundit të Metrosë, në Athinë,

dy të moshuar , një çift i përqaftuar , dy lypsa fëmijë dhe dy zezakë , si dhe unë me një çantë të madhe në krahë .

Dalloj që larg në bulevard një fshesar , paksa i plakur dhe kurrizdalë , që bashkë me gjetet mbledh edhe pritjet ,

bishta cigaresh , dhe tonelata fjalë . . .

I ngrohtë përqaftimi i Athinës , nëpër natë . . .

Vite e dua këtë avër të veçantë !

Kush shkeli këtu , me të u dashurua , Athina e bëri , me e dashtë .

Shshhttt . . . dëgjojani frymëmarjen kësaj Zonje ,

teksa kërcen nën tantelat e shkumës së bardhë ,

zog qytetërimi i lashtë , pulëbardhë nëpër dallgë . . .

Fustan kaltër , puthjezjarr , pllenuar me dritën, perëndimet ,

mal edhe det dashuruar me agimet .


Në vagonin e fundit të Metrosë në Athinë ,

fshihet një sekret poetik , me frymë . . .

Për fund, e përgëzoj përzemërsisht këtë poete brilante për këtë libër të mrekullueshlm, duke i uruar suksese të mëtejme në lëvrimin e poezive racionale e filozofike!

ZEKERIJA IDRIZI

Prindërimi, sa i bukur aq dhe i vështirë



Fran GJOKA

Jo thjesht për të shuar kureshtjen, por si një obligim për fëmijët, për të ardhmen e afërt dhe të largët të tyre, do të ngulmonim se, trinomi shkollë - familje - mbetet gjithnjë faktor primar dhe që kërkon vlerësim të vazhdueshëm për edukimin dhe mirërritjen e fëmijëve ndaj me te drejte bejme pyetjen: Prindi apo mësuesi, kush ndikon me shume ne edukimin e brezit të ri? Në realitetin e sotëm, kur shkolla po integrohet gjithnjë e më tej drejt standardeve bashkëkohore evropiane, kur tekstet e programet po pasurohen dhe alternohen me përzgjedhje dhe cilësia e tyre vjen e rritet, pjesëmarrja e prindërve dhe ndihmesa e tyre në të mësuar po merr rëndësi të veçantë dhe po shfaq tipare e rrugë të reja në menaxhimin sa më racional të kohës, për t'u dhënë ndihmë sa më të kualifikuar dhe efektive fëmijëve tanë. Që të realizohet plotësisht dhe pa ekuivoqe ky objektivi madhor, doemos që duhen investuar energji pune konkrete edhe nga prindërit, familja që është baza e shoqërisë dhe që përgatit fëmijën për t'u futur në rrugën e shkollimit, që ta përgatit atë si një lastar të freskët, të drejtë dhe pa cene e dëmtime fizike e biologjike. Kjo është një garanci e madhe që fëmija të integrohet sa më mirë dhe sa më natyrshëm në mjedisin shkollor dhe të ecë përpara drejt rritjes dhe zhvillimit të tij të vazhdueshëm si qytetar i shoqërisë moderne.

Që të edukosh dhe të moralizosh, duhet të jesh vetë një shembull jete, pune dhe edukimi. Dhe, si i tillë, je në gjendje të ndihmosh fëmijën më shumë sesa me fjalën tënde, me veprën tënde, me të qenit qytetar dhe njeri, me karakter të fortë dhe të palëkundur për të përkrahur të renë dhe përparimtarë, kërkesat e kohës dhe të zhvillimit. Kjo nuk do të thotë që të gjithë prindërit duhet doemos të jenë në kulmin e shkollimit, që të jenë në krye të shkencave dhe zhvillimeve, sepse këto janë raste që nuk i gjen me bollëk, por që të jesh njeri dhe qytetar i denjë në radhë të parë, që të transmetosh në jetë dhe në punë vlera njerëzore, kjo varet nga gjithkush, nuk ka të bëjë as me përgatitjen

shkencore dhe sociale, por me qëndrimin njerëzor ndaj jetës, punës, njeriut. Kjo ka shumë rëndësi në edukimin e njeriut dhe veçanërisht në edukimin e fëmijëve me vlera morale dhe njerëzore, por edhe me vlera që hapin horizonte dhe të zgjojnë dëshira, nxitje dhe kërkesa për të ecur në jetë dhe për të dhënë secili kontributin e tij në këtë shoqëri moderne, ku ne jetojmë sot.

Por, sidomos mendojmë se është e domosdoshme që anëtarët e familjes kërkohet të jenë model në shfrytëzimin sa më racional të kohës për t'u marrë me edukimin dhe mirërritjen e fëmijëve. Kjo do të ndikonte në mënyrë të drejtpërdrejtë në përgatitjen psikologjike dhe formimin me aftësitë dhe shprehitë më të nevojshme dhe më elementare për t'u integruar sa më lehtë dhe sa më natyrshëm në shoqërinë e sotme demokratike. Në këtë kuadër, fëmijët t'i edukojmë të zbatojnë me rigorozitet një regjim ditor, që, është në përputhje me orientimet dhe këshillat e specialistëve, psikologëve dhe sociologëve, edukatorëve që kanë përvojën e punës frytdhënëse e që garanton të ardhmen e sigurt të fëmijëve. Dihet se fëmijët nuk janë të njëjtë për të gjithë, sepse secili ka përgatitje e aftësi të ndryshme për të kapur me shpejt ose më ngadalë fjalën vjen nivelin përveçësues të dijeve që merren në shkolla. Nëse nxënësve me prirje të veçanta dhe të talentuar, u mbetet më shumë kohë e lirë që



të mund ta shfrytëzojnë për zgjerimin e horizontit, për të mësuar gjuhët e huaja për zbatim, pushim etj., nuk ndodh kjo me ata që janë disi më të ngadaltë dhe që u mungon pasioni dhe dëshira, apo që edukimi i tyre i lihet spontanitetit, në radhë të parë nga ata prindër që, ose nuk i kanë kushtet e duhura ekonomike dhe sociale dhe arsimore, apo ata që neglizhojnë me edukimin e fëmijëve, duke u kënaqur vetëm me faktin se i kanë shpërfaqur fëmijët e tyre në shkollat më të mira, se u japin para çdo ditë për të plotësuar kërkesat e tyre etj. Një prind i tillë harron se, më shumë sesa biznesi i madh që drejton, më shumë sesa ato para që ai depoziton dhe shtonë përditë në bankë, investimi i tij më i madh është dhe mbetet në radhë të parë edukimi, mirërritja dhe shkollimi i fëmijës së tij, që ai të ndjek rrugën e

drejtë të dijes për t'u bërë dikush në jetë dhe jo të mburret apo të jetojë me thërrimet apo emrin e babait të tij. Sigurisht që është e domosdoshme të hiqet dorë nga privimi i fëmijëve nga aktivitetet çlodhëse, që fatkeqësisht praktikohet nga disa prindër. Pushimet e çlodhjes duhet t'u kushtojnë po aq rëndësi sa edhe mësimit sepse ato shërbejnë për freskimin e sistemit mësues, gjë që ndikon për mirë në përvetësimin e dijeve. Psikologët e sotëm rekomandojnë që fëmijët t'i mësojnë e realizojnë herë pas here administrimin e kohës, ato kërkojnë që brenda ditës nxënësit të dijë se çdo të bëjë dhe çka bërë. Por fëmijët nuk e kanë të lehtë që të bëjnë këtë punë në rrugë krejtësisht të pavarur, ata kanë nevojë për ndihmën e prindit, që të ndërgjegjësohen se sa kohë kanë harxhuar për gjëra të parëndësishme në dëm të problemeve mësimore.

Psikologu Alan në librin e tij që titullohet "Si të arrini të kontrolloni kohën dhe jetën tuaj", këtij problem i vë shumë rëndësi. Me pak fjalë ai thotë se njerëzit më të suksesshëm e dinë mirë se çdo të bëjnë ditë për ditë. Kur veprohet kështu, nxënësit do të mësohen ta shfrytëzojnë kohën me projekte produktive. Kjo ka rëndësi shumë të madhe jo vetëm për kohën e shkollës por edhe si përgatitje për jetën. Ka raste që fëmijëve ua marrin kohën edhe prindërit. Jo rrallë ndodh që ata t'i ngarkojnë kohë pa kohë me punë të

nxënësve në shtëpi mbetet problem përfundimtar në rritjen e cilësisë së procesit mësues. Edhe bota e jashtme akademike, këtij problem i kushtojnë një vëmendje të veçantë, aftësinë dhe dhuntinë natyrale të nxënësve të sotëm nuk duhet ta lëmë të na firojnë gjatë periudhës shkollore është edhe një nga objektivat e reformës së sotme arsimore. Ndodh shpesh që të dëgjosh nga goja e mësuesve e prindërve akuza të forta si më zemërim thonë: "Janë të zgjuar, por nuk mësojnë". Kjo akuzë prindërore ndaj mësuesve lëshohet nga ata që bëjnë pak ose aspak punë për t'i ndihmuar që të ndryshojnë qëndrimin e tyre ndaj mësimit. Kjo kategori mësuesish e prindërish harrojnë se shoqëria e sotme shqiptare i ka thirrur pikërisht ata që t'i edukojnë edhe këta nxënës me shpirtin e disiplinës shkencore në mësime. Psiko - pedagogët kanë provuar se po të orientohen mirë edhe mjaft nga këta fëmijë bëjnë përpjekje për të kapërcyer vështirësitë. Mësuesit në bashkëpunim me prindërit duhet të punojnë për t'i kalitur vullnetin nxënësve, që të mund të përballojnë edhe vetë kryerjen e detyrave mësimore jetësore në rrugë të pavarur.

Kjo kërkesë vlerësohet si shumë e rëndësishme dhe bën pjesë në kulturën e re të të nxënësve. E parë në këtë këndvështrim me keqardhje vërejmë aty-këtu në shkollat, ku mjaftohen edhe me akuza (këta janë nxënës që nuk mësojnë). Dhe s'bëjnë asgjë konkrete për t'i ndihmuar. Është fatkeqësi e madhe kur fëmijët bien në duar të disa prindërve dhe mësuesve të tillë. Prindërit e mësuesit nuk duhet të tërhiqen nga vështirësitë që paraqet puna më këtë kontigjent nxënësish, sepse po të punohet mirë vjen një ditë kur ata shpërthejnë. Mjafton të kujtojmë edhe Ajnshtajnin që deri në moshën 9 - vjeçare nuk fliste normalisht. Në shpirtin e çdo mësuesi duhet të ç rrënjohet mendimi antipedagogjik që dëgjohet "Shyqyr që ikën, shpëtuam prej tyre!". Kjo mënyrë e të gjykuarit ndeshet në disa shkolla të mesme sidomos tek mësuesit që punojnë me klasat e para dhe të dyta. Duhet të pranojmë se mbartësit e këtyre koncepteve nuk mund të quhen me edukatorë të vërtetë. Jeta shkollore dhe ajo prindërore ka provuar se po të veprohet me kritere shkencore dhe me përkushtim, kjo masë nxënësish mund të përmirësohet dhe të integrohet në veprimtaritë mësimore dhe edukative. Kontrolli i shfrytëzimit racional të kohës ka mjaft vlera konkrete, se parandalon shpërdorimin e saj që është shfaqja më e rëndë e keq administrimit të mundësive reale që ka secili për të ecur përpara. Për këtë problem në kohën e tij ka folur dikur edhe Gjergj Fishta "Si ka me u rritë, siç e lyp arsyeja e detyra po qe se prindërit nuk janë të qytetënuar e përparuar. Prandaj për në daçim që shteti shqiptar të përparojë në udhë të qytetënisë së vërtetë, përpara çdo pune tjetër duhet pasë parasysh edukata e familjes shqiptare tue ba që prindët si dhe fëmija e tyre të jenë të qytetnuem". Kaq rëndësi i vë ai këtij problemi. Pra mësimi dhe edukimi mbeten një proces aktiv që zhvillohet pa ndërprerje çdo ditë.

Asnjëherë shkolla nuk është normale, në se nuk ka të kristalizuar misionin, qëllimin, funksionin dhe natyrisht edhe statusin dinamik të dy figurave të përjetshme të saj: mësuesit dhe nxënësit

Fran Gjoka

Koha e re e lirisë dhe demokracisë e ka detyruar shkollën moderne, për t'i përmbytur këto role të determinuar, këto pozicione të "stratifikuar" të qëndrimit dhe vlerësimit interdogmatik, të marrëdhënies midis mësuesit dhe nxënësit. Është e sigurt që shkolla demokratike shqiptare është duke krijuar dhe konsoliduar një relacion të ri, interaktiv, në marrëdhëniet midis tyre. Kjo do të thotë se raporti i mëparshëm, që njëri flet dhe tjetri dëgjon ka ndryshuar radikalisht. Në shkollën e sotme, marrëdhëniet midis mësuesit dhe nxënësit janë të tilla, që të dy kanë marrëdhënie që ndikojnë mbi njëri-tjetrin, dhe të dy bashkë mbi të tjerët (shoqërinë). Shkolla nuk është më institucion edukativ i mbyllur në guaskën e relacionit të fosilizuar, determinist të mësuesit me nxënësin. Ajo është institucion social i rëndësishëm, në të cilin kultivohen vlerat e shoqërisë dhe individit. Nxënësi nuk është më njeriu i klasifikuar sipas metodës së vjetër pedagogjike, në rolin pasiv të dëgjuesit dhe të të nxënës. Ai nuk është njësi e thjeshtë statistikore dhe e amzës. Çdo nxënës është një qenie njerëzore me cilësi, botë shpirtërore dhe identitet specifik, që ka qëllimet dhe synimet e veta të personalizuar. Shkolla moderne nuk është më institucion që i ndërton marrëdhëniet e mësuesit me nxënësin mbi parime të vjetra të "paternalizmit mekanicist", sëmundje e vjetër nga e cila ende nuk është shëruar shkolla jonë. Pedantizmi i mësuesit, mbivlerësimi i rolit të tij dhe nënvleftësimi i personalitetit të nxënësit është njëri nga shkaqet, në mos kryesori që sjell konflikte pedagogjike në marrëdhëniet midis tij dhe nxënësit në shkollë. Personalisht, gjithnjë kam menduar se ka patur të drejtë Kanti i madh, ky filozof universal i iluminizmit kur thoshte se "despotizmi më i keq është paternalizmi". Kur flasim për këtë raport pedagogjik delikat të natyrës bipolare, për këtë relacion dinamik, midis dy figurave qendrore dhe të vetme të edukimit në shkollë siç janë mësuesi dhe nxënësi, duhet të mendojmë se nuk kemi përballë dy "qenie të zbrazura" apo "njerëz të kulluar". Mësuesi dhe nxënësi janë dy "entitete njerëzore", identitete sociale të ndryshme. Kjo do të thotë se ato janë dy figura që kanë mendimin e tyre për njëri-tjetrin, të kondicionuar natyrisht nga relacionet sociale të jetës së sotme në vendin tonë, në kontekstin e të cilës "bashkëjetojnë" mësuesi dhe nxënësi. Ata në kushtet e shkollës moderne nuk duhet të jenë "rivalë", por partnerë që kanë një mision të përbashkët. Në një farë mënyre ajo që po ndodh në shkollën e sotme, është fakti që këto marrëdhënie tentojnë drejt një partneriteti interaktiv, funksionues dhe të barabartë. Në çdo kuptim që ta shikojmë shkollën moderne, ajo është dhe do të jetë një institucion i madh, jo vetëm pedagogjik por dhe i marrëdhënies

demokratizuar midis mësuesit dhe nxënësit. Shkolla është vatër e madhe e "demokracisë së vogël". Aty ndërtohen marrëdhënie midis dy subjekteve që e ndërtojnë hierarkinë e tyre, duke respektuar lirinë, identitetin dhe "rolet" e njëri-tjetrit. Demokratizimi i marrëdhënies mësues -nxënës, natyrisht nuk ka terren për anarki pedagogjike. Por as shkak për të trembur mësuesin që nuk komunikon demokratikisht, apo argument në favor të nxënësit rebel. Në këtë kontekst, shkolla si çdo institucion tjetër social, ka parime ndërtimi dhe rregulla e rregullore funksionimi që garantojnë marrëdhënie të drejta, lirinë "pozitive" dhe "negative", për mësuesin dhe nxënësin. Kjo do të thotë që nxënësi dhe mësuesi janë të lirë të ndërtojnë marrëdhënie produktive, duke u nisur nga parimi demokratik dhe pedagogjik, sipas të cilit në shkollë "liria e nxënësit" mbaron aty ku fillon e "drejta e mësuesit", dhe anasjelltas, e drejta e mësuesit mbaron atje ku fillon liria dhe e drejta e nxënësit për të gjykuar, menduar dhe vepruar. Në tërë këtë hapësirë lirie, nuk ka arsye pse të kemi përplasje midis nxënësit dhe mësuesit. Këto relacione nuk ndërtohen me mentalitete dhe paranojat e pedagogjisë së vjetër autoritariste, që nuk respektton të drejtën dhe liritë e nxënësit për të qenë figurë aktive në shkollë. Koha kërkon që "hapësirat respektive" të mësuesit dhe nxënësit, për të luajtur rolet e tyre si mësues dhe nxënës, të jenë të qarta. Normalisht sipas meje, liria pedagogjike dhe demokratizimi i marrëdhënies mësues-nxënës, nuk mund të realizohen duke ndërhyrë padrejtësisht në hapësirat e njëri-tjetrit, duke krijuar anarki dhe kofoni pedagogjike, marrëdhënie kaotike, të paqarta, që sjellin konflikt midis tyre. Këto situata jo arkaike të vjetra pedagogjike, as me mentalitete paranojake reciproke, midis mësuesit dhe nxënësit. Mbase ka ardhur koha për të riparë këtë relacion, në të dy drejtimet kryesore të demokratizimit të shkollës dhe marrëdhënies mësues - nxënës. Kjo kërkon që nga njëra anë të ridimensionohet koncepti për "autoritetin e mësuesit", duke e forcuar dhe demokratizuar jo si "autoritet të jashtëm", që sjell autoritarizëm dhe konfliktualitet në marrëdhëniet me nxënësin. Por nga ana tjetër, nuk duhet asnjë lëshim në konceptin që liria e nxënësit në shkollë është pozitive, që do të thotë që ai është i lirë të mësojë dhe edukohet duke ju respektuar prirjet, dëshira dhe personaliteti. Por ajo është edhe "liri negative", në kuptimin që sjellja e nxënësit është e detyruar të jetë e përputhur me rregullat, rregulloret, parimet pedagogjike të shkollës, si institucion social. Ndërkaq mësuesi është i detyruar që me mjeshtërinë, përvojën, aftësinë, fleksibilitetin pedagogjik, (jo me dogmatizëm) të krijojë kushtet normale dhe atë "situatë pedagogjike", në të cilën nxënësi të ketë mundësi të zgjedhë alternativë veprimi, kulturimi në përputhje

me dëshirat, aftësitë dhe prirjet personale. Kjo liri pedagogjike, nuk ka pse të jetë e huaj për shkollën tonë moderne, në se mësuesi dhe nxënësi dinë të respektojnë njëri-tjetrin, duke luajtur secili rolin e vet. Me fjalë të tjera, ka ardhur koha që në shkollë të punojmë që duke e demokratizuar atë dhe marrëdhëniet midis mësuesit dhe nxënësit nga njëra anë, po kaq seriozisht të mendojmë për një "rikonceptim të roleve" dhe statusit të secilit, si mjet për mbarrëvajtjen e punës dhe procesit mësimor dhe edukativ. Çështja e njohjes dhe respektimit të statusit të mësuesit dhe nxënësit, ndikon në krijimin e një atmosfere të veprimit të "hierarkisë shkollë", e cila është e domosdoshme për një institucion të tillë, me mision social dhe pedagogjik siç është shkolla. Në se do të arrimë që në shkollë të kemi përfytyrime të drejta për statusin e mësuesit dhe nxënësit, duke respektuar të drejtat institucionale të secilit, atëherë kemi për të patur një atmosferë marrëdhëniesh të mirëkuptimit reciprok. Kjo është ajo që i duhet shkollës, për të patur efikasitet dhe efikasitet socio pedagogjik, rezultate të prekshme dhe gjurmë të thella të relacioneve shpirtërore midis mësuesit dhe nxënësit. Nuk ka pse të ngatërrojmë shkollën me koncepte të skajshme konservatore, arkaike të pedagogjisë së vjetër e të re, që janë provuar se kanë qenë dhe janë kundër produktive, të panatyrshme për shkollën moderne shqiptare, në stadin e sotëm. As nxënësi, por as mësuesi nuk janë ata që kanë qenë dikur, as marrëdhëniet e tyre nuk ndërtohen mbi parime të vjetra që ngatërrojnë "stauset reciproke", që dëmtojnë punën e shkollës. Shkolla nuk është as vend i "pavarësisë së nxënësit" nga mësuesi, por as fushë beteje për të treguar "unin" apo egocentrizmin pedagogjik të këtij të mësuesit. Natyrisht mësuesi është në një situatë të veçantë, sepse është i detyruar të komportojë sjelljen dhe "unin" e tij, me nxënësin e tij që janë në të njëjtën kohë "grup", "tërësi kolektive" që duhet njohur, punuar dhe respektuar jo vetëm si grup, por dhe individualisht. Natyra e profesionit dhe e marrëdhënies të tilla kontradiktore, të punës me "grupin" dhe "individin" në të njëjtën kohë, është ajo që e bën të vështirë, delikate, me përgjegjësi dhe të lodhshme punën e mësuesit në shkollë. Ndaj është aq shumë e respektuar puna e mësuesit të vërtetë, të cilën nuk mund ta bëjë kushdo. Ai është mjeshtër për të gjetur "masën", midis lirisë dhe disiplinës që duhet të respektojë nxënësi në shkollë. Kjo do të thotë që duhet me kujdes të shikojmë atë raport delikat të të drejtave dhe lirive të natyrshme që ka nxënësi (liria pozitive), me atë të drejtë që ka shkolla dhe mësuesi për nxënësin që të respektojë rregullat dhe parimet e ndërtimit dhe funksionimit të shkollës (liria negative). Sipas mendimit tim midis këtyre "dy lirive", midis mësuesit dhe nxënësit është ajo situatë që ndikon në përcaktimin e statusit të tyre,

është pikërisht ajo gjendje që mundëson funksionimin ideal të marrëdhënies, pa cenuar dhe nëpërkëmbur të drejtat e njëri-tjetrit. Shkolla është institucion dhe natyrisht që ka nevojë për "hierarki" vlerash dhe njerëzish, që kanë role të ndryshme bashkëpunuese. Konceptet e vjetra të shkollës hierarkike, janë shpesh shkak për konflikte dhe situata të pakëndshme, midis mësuesit dhe nxënësit. Në se do të duhej të gjeja një term, që mund të përcaktojë se si duhet të jenë në kohën tonë marrëdhëniet e mësuesit me nxënësin, unë do të preferoja që ato në esencë të jenë në pozicionin e "hierarkisë së harmonishme". Nuk mund të ndërtohet shkolla e re e demokratizuar me mësues që kanë në mendje ide dhe konceptet e shkollës së vjetër totalitariste që e shtypte lirinë e nxënësit. Tani është kohë tjetër dhe natyrshëm shkolla është e detyruar të mbajë "barrën e lirisë", të institucionit të lirë, që nuk ka për mision të edukojë nxënës të trysnuar me parime të moralit dhe pedagogjisë së vjetër. Shkolla tani është një institucion që ka tjetër mision, të edukojë qytetarë aktivë, të guximshëm, humanë, antikonformistë, me personalitet të fuqishëm e të pavarur. Këto vlera dhe cilësi që duhet të kultivojë shkolla, nuk mund të realizohen me konceptin e vjetër të statusit të mësuesit si tutelë mbi nxënësin pasiv, timid, të flashkët, pa vetëdije personale. Shkolla është vendi i parë ku nxënësi kërkon të afirmojë personalitetin dhe identitetin e vet të dallueshëm. Kjo kërkesë dhe dëshirë e natyrshme e nxënësit, nuk ka pse të cenojë personalitetin e mësuesit të "lëkundur", i cili nga që mund të mos jetë i aftë të përballojë këtë kërkesë legjitime, trembet e kap paniku dhe nervozizmi pedagogjik. Dëshira e nxënësit për të afirmuar personalitetin, nuk cenon aspak, nuk e vë në krizë autoritetin e mësuesit të talentuar, që di të kuptojë këtë aspiratë të nxënësit, duke ndërtuar ndërkaq marrëdhënie të mira ndikuese me të. Nuk është e drejtë frika që kanë disa mësues, për "kufijtë" e cenuar të autoritetit të tyre. Sipas mendimit tim, pavarësisht proceseve demokratizuese që kanë përfshirë shkollën tonë, ka për të qenë kurdoherë e pranishme dhe e diskutueshme pyetja e mësuesit se "deri ku duhet të shtrihet autoriteti" i tij. Por ndërkaq edhe nxënësi ka po aq të drejtë të pyesë, se "deri ku janë kufijtë e lirisë" së tij. Kjo situatë dikotomike midis "autoritetit të mësuesit" dhe "lirisë së nxënësit", është dhe do të jetë problem i përjetshëm, ekzistencial i shkollës. Asnjëherë shkolla nuk është normale, në se nuk ka të kristalizuar misionin, qëllimin, funksionin dhe natyrisht edhe statusin dinamik të dy figurave të përjetshme të saj: mësuesit dhe nxënësit.

Me çfarë dëgjojmë lumsi ne, me çfarë shohim...?

Fushata për zgjedhjet e 11 majit, ka kohë që ka filluar me kohe, ndërsa juridikisht filloi me 11 prill 2025. Kur dëgjojmë nga të gjithë krahët e politikës, mendja të shkon se kur do vijë 12 maji?! Shtresat e varfra e të mesme, pyesin veten se ku mund t' i shpenzojmë gjithë ato para, që do na jepen? Ka nga ata, të cilët, bëjnë gati plaçkat dhe me një pasaportë të ngritur lart me dorën e majtë, atë të Bashkimit Evropian, dhe në dorën tjetër valixhen me ato pak rraqe drejt Evropës. Kjo do të thotë se edhe ata pak që kanë mbete në Shqipëri, t' ia mbathin! Dihet se pasaporta nuk i ka penguar rreth një milion Shqiptarë të largohen nga vendi. Tre dekada ka që mashtrohemi do hymë sot e do hymë nesër në Evropë. Kemi pirë shampanjë e dëgjuar muzikë, duke festuar hyrjen në Evropë. Tani jemi afra, madje dje u hap dera. Për ne duket se, tani janë ndryshkur menteshat, duhen vite që të grasatohen. Çdo njeri e di, se hyrja në Evropë, ka ca kushte, të cilat ne nuk i kemi plotësuar. Korrupsioni galopant, krimi i organizuar, lidhje e krimit me politikën, varfëria që ka pllakosur vendin janë ata faktor që na mbajnë larg Evropës. E thënë troç se politikanët e kësaj qeverie janë kthyer në kriminel. Çdo ditë të kollarisur mbi kolltuk, madje këmbët mbi tavolinë. Nder kohë natën në skuta terri bashkë me kriminele. Këto janë të faktuara, me të cilët po merret drejtësia. Falë gazetarëve e mediave të pa kapura nga pushteti, se këtu mund të bëhej edhe me keq. Po edhe opozita e gazetarë investigative që ja hapen petët lakrorit me denoncimet e tyre.

Le të kthehemi te fushata, një pale me program të detajuar për çdo sektor, me afate, dhe rrugët për realizimin e tyre. Pala tjetër nga viti 2013 e në të gjitha fushatat e tjera, ka dale para popullit me: Tepsi e timon, se e keqja ishte LSI? Fushatat tjera dauille e tupanë, ndërsa tani ka dale me pasaportë dhe me një gjuhë denigruese, duke notuar nëpër moçale e kënetë. Lind pyetje: Si i kanë votuar tash 12 vjet? Përgjigja dihet!!! Deri kur do i qëndrojmë thënies se "budalla është livadh i të mençurit!" Por populli nuk është budalla, budallonjë janë ata që mashtrojnë se një ditë do ju vijë radha për te drejtësia.

Për Dukagjinin është bërë rruga Qafë Terthore - Nderlysa, e cila ndihmoi shumë në zhvillimin e turizmit. Ka shumë vite që është premtuar për rikonstruksionin e rrugës të Dukagjinit. Dhe falë bashkimit të Dukagjinasve, pa dallime partiake, të cilët protestuan fuqishëm, filloi puna. E megjithatë cilësia lë për të dëshiruar. Sipas mediave vizive betonin e shkoqin me thonjtë.

Në fushat, dilet me programe, por edhe me bilance. Çfarë është realizuar e çfarë nuk është realizuar? Për mos realizimet për faktor subjektiv duhet bërë autokritikë. Disa here është premtuar për auto-



stradën Milot - Balldren dhe ende nuk ka filluar. Pas shumë vitesh u kujtuan për rikonstruksionin e rrugës së Komanit. Infrastruktura që do ndihmonte shumë turizmin për në lumin e Shalës.

Tani në prag të zgjedhjeve u kujtuan se duhej përfunduar prej kohësh. Po kalaja para disa ditësh në ato krahina, dhe përsëri më shkoi mendja te titulli i këtij shkrimit. Te rruga e Dukagjinit, e cila u

shpërndau dokumentet e legalizimit të ndërtesave të ndërtuara para viteve 1990. Të gjithë pjesëmarrësit e falënderuan sepse bashkë po merrnin atë që ju takonte. Këtu nuk mbeten pa batuta, madje deri në qesharake. Ajo që të bie në sy ishte ndarja në mes atyre me bindje të majta e të djathta. Sikur po ju falte pronat e tij në jug, e jo pronat e trashëguara prej shekujsh e më saktë qysh në vitin 1485.

Pra, Thethi është njohur me 7 shtëpi, që në vitin 1485. Pra, çdo kush mendon se u kthyer në identitet, por gabon, ose nuk e di se identiteti i jone, daton 540 vite më pare. Për këtë falënderim e mirënjohja, ju takon 12 brezave deri te Dedë Nika, që na lanë trashëgim këtë perlë, më të bukurën në Evropë.

Kaloi një vit dhe ende nuk janë marrë çertifikatat e pronësisë!

U premtua se shtëpitë e rrënuara do të legalizohen... Përfunduan matjet dhe po pritet për legalizimin e tyre. Ende asgjë, madje shumë emigrantë pyesin se, kur do të legalizohen ato objekte, të cilat ishin plotë me burra, gra, djem, vajza e fëmijë, që të kthehemi e të ndërtojmë, madje edhe për biznes.

Po çertifikatat e pronësisë sipas kufijve

njohur, shume shekuj më pare nga shteti i Venedikut. Është botuar në disa gjuhë të botës, si vet administrim shoqërorë dhe me gjithë këto merita të njohura botërisht, bashkia e Shkodrës nuk pranon ta "pasaportizojnë", në një vend të dukshëm në sheshet kryesore te qytetit.

Padrejtësitë për Dukagjinin janë të shumta, nuk po i listojmë, po mund të përmendim Reformën territoriale, e cila tentojë të eliminojë Dukagjinin si treve, këtë nuk kanë arrite as pushtuesit Osman, malazez e të tjerë. Mendoj se shumë gjera kishin marrë rrugë sikur Dukagjini në parlament të përfaqësohej nga vetë Dukagjinasi. Zëri tyre do të dëgjohej më shumë.

Ne themi u rrite ndera atyre subjekteve, të cilat kanë zgjedhur kandidat për në parlamentin e ardhshëm, këta burra, gra, djem e vajza dukagjinasi, të gjithë e meritojnë një ulse, në atë tempull të demokracisë, ashtu që Dukagjini është përfaqësuar në kuvende të rëndësishme në histori. Por duhet të mendojmë, vota mos të tjetërsohet, të mos parcelohet, ende e renda është shitblerja saj.

Të mos ndodh, që dukagjinasi për besë kanë dhënë djalin. Pra, edhe vota është në



bë legjendë, ditën ndërtohet dhe natën shembet, duke marrë edhe jetë njerëzish fatkeqësisht.

Në vitin 2020 doli vendimi 20/20. Për pronat në malësi e për shtëpitë e ndërtuara para viteve 1990. U prit me falënderime se tokës në malësi duhet dhënë pronësia sipas kufijve të vjetër. Janë bërë investime të fuqishme në këto zona, kryesisht në Theth, po në themel nuk kanë kryesoren: çertifikatën e pronësisë. Pjesa më e madhe, është djersa e emigrantëve.

Sot ne, ju bëjmë thirrje kthehuni për të investuar në Shqipëri, por ende nuk janë ligjëruar ato prona të trashëguara. Po bëhet një vit, kur Kryeministri Edi Rama

të vjetër mbetën vetëm në letër. Shumë enigma qarkullojnë, disa gojë të liga thonë se çertifikatat nuk jepen se, do merren tokat për investitorë në kuadrin e Paketës së maleve!!! Duhet tu tregojmë këtyre gojëve të liga, se Dukagjini nuk do të lejojë asnjëherë tjetërsimin e pronave të tyre.

Sistemi monist ka dokumentacion se, në vitin 1947 ka bërë matjet e këtyre pronave, për të cilat janë paguar të gjitha taksat e kohës.

Ne nuk po arrima të vendosim bustin e princit të Lek Dukagjinit edhe pas protestave të bëra para Bashkisë Shkodër. Gjithë Evropa e respekton për veprën e tij, Kanuni i Lek Dukagjinit, i cili është

një kuptim si besa e dhënë. Të 5 njësite administrative të kësaj treve duhet të votojnë për kandidatet Dukagjinasi kudo që janë brenda vendit e në diasporë.

Jam i bindur se sikur në parlamentet e kaluara, të kishte përfaqësues nga Dukagjini, do ishin bërë investime më shumë, se 90 për qind të atyre që theksuam do ishin realizuar.

Pra, me 11 maj të votojmë ato subjekte të cilat na bindin, po gjithmonë për kandidatet Dukagjinasi!

Përgatiti Ndue ZIÇI,
Lezhë, Prill 2025

Folkloristika

Kontributi i të huajve dhe shkodranëve

Kontributi i shkodraneve në çdo fushë është kaq i madh sa më vjen keq të them, që të gjitha keto arritje të kultures shkodrane janë të paraqitura shumë dobet dhe ceket në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar të viteve 2008 - 2009, sa në keto studime, që paraqes kane per qellim të nxjerrin më në drite kontributine gjithanshem të shkodraneve, që nuk duhet të na i mohojë askush.

Është shkenca që studion folklorin.

Fillesat e interesimit për traditat popullore shqiptare shfaqen që në veprat e shkrimtarëve të vjetër, si Frang Bardhi, i cili ka bërë edhe përpjekjet e para që njihen për mbledhjen e folklorit shqiptar. Në fushën e folklorit, në trevën e Shkodrës, ka pasur përpjekje për të nxjerrur në dritë vlera të krijimtarisë shpirtërore të popullit tonë. Me vlera të mëdha njohëse në fushën e folklorit në Arkivin e Arqipeshkvisë së Shkodrës, është një dorëshkrim i shekullit XIX e fillim i shekullit XX prej 29 faqesh në gjuhën shqipe me këngë trimërie dhe vjersha të tjera. Mjaft studiues të huaj dhe vendas mblodhën, botuan e studiuan eposin e kreshnikëve që tashmë ballafaqohet me atë sllav, legjendat, përrallat dhe këngët. Pra, një pjesë të rezervatit të traditës gojore, që ishte ende gjallë në Malësitë e Veriut. J. G. V. Hahn, rezultoi të jetë mbledhësi dhe botuesi i parë i folklorit shkodran, i cili ka shkruar 4 poezi geqe dhe një numër të konsiderueshëm enigmash geqe. Filologu çek, J. U. Jarnik në dy vepra të tij në hapësirën kohore midis viteve 1881 - 1883, ka botuar tekste folklorike shqiptare, sipas të cilit burimet i ka marrë nga shkodrani Mark Shantoja. Joseph Muller, në vitin 1884 në një vepër të tij flet për Pashallekun e Shkodrës, kur thotë se shqiptarët e këtyre pashalleqeve krenohen për Gjergj Kastriotin. Albanologu G. Meyeri, në veprën e tij ka mjaft lëndë folklorike nga Shkodra dhe Mirdita. Në parathënien e veprës së tij të botuar më 1897, ai shkruan se, të dhënat i ka marrë nga nënkonsulli austro - hungarez në Shkodër, Rappaporti, që kishte mbledhur lëndë folklorike. Midis mbledhësve të huaj të folklorit nga trevat e Shkodrës është edhe Mark Milani.

M. Lambertzi ka një meritë të veçantë në ndriçimin e folklorit të rajonit të Shkodrës.

M. Parry ka regjistruar këngë kreshnike në gjuhën shqipe. Po kështu kanë dhënë ndihmesë Cordinjano, M. Murko, Simini, Zef Valentini, S. Gopcevic, e të tjerë.

Etnografi gjerman Paul Traeger (1867 - 1933) udhëtoi disa herë në Shqipëri dhe bëri edhe disa incizime të realizuara më 1903 në Shqipërinë e Veriut, duke mbledhur material të folklorit muzikor. Regjistrimet e Traeger-it janë këngët kryesisht ndër fiset e pavarura të maleve, këngë vokale dhe instrumentale kryesisht nga trevat e Mirditës dhe Shkodrës

Më 1871, Zef Ndokillia Jubani, botoi në Trieste librin: "Përmbledhje Këngësh popullore dhe rapsodi poemash shqiptare", që është përmbledhja e parë e folklorit nga një autor shqiptar brenda vendit. Pjesëtarë të klerit katolik, si Lazer Mjeda, Nikollë Gazulli, Nikollë Kimza, Nikollë Kaçorri, Ndre Zadeja, e Gjon Karma, u morën me mbledhjen e folklorit dhe gjetjet e dukurive etnologjike, por punën themelore e kryen françeskanët si: Shtjefën Gjeçovi, Vinçenc Prennushi Bernardin Palaj, Donat Kurti, Marin Sirdani, Nikollë Dajçi, Bernardin Llupi, Simon Mikeli, Leonard Shajakaj, Rrok Gurashi, por edhe të tjerët, do të vilnin këtë pasuri të çmuar, e cila do të përbente serinë e shkëlqyer disa vëlimeshe të "Visareve të Kombit".

Françeskanët nuk ishin vetëm mbledhës të thjeshtë të këngëve, por edhe njohës të teknikës së regjistrimit të tyre, njohës të varianteve të ndryshme (motërzimeve) të të njëjtës këngë dhe në tërësi të biologjisë dhe morfologjisë së kësaj teknike të të kënduarit popullor. Ata u endën në të gjitha mjediset gjeografike të hapësirës ku gjallonte krijimtaria gojore me këngë, legjendat, përralla e të tjera.

*Nismëtari i kësaj sipërmarrje ishte pa dyshim At' Shtjefën Gjeçovi, i cili, që kur ishte famullitar në Laç të Kurbinut, kishte nisur gjurmimin dhe mbledhjen e këngëve popullore, legjendave si dhe dokeve kanunore të kësaj krahine, e cila do të vijojë më pas në Zara, Troshan, Gomsiqe e Kosovë, duke u bërë kështu i pari folklorist shqiptar që mblodhi letërsinë gojore në mënyrë sistematike dhe shkencore.

*Në vitin 1911, At Vinçenc Prennushi do të botojë "Kangë Popullore gegnishte". Në parathënie autori thotë: "E qe, ky është më i pari libër i veprës "Visari komtar".

*Donat Kurti, është një nga personalitetet qëndrore të folklorit shqiptar. Libri në dy vëllime "Përralla kombëtare", është botimi më komplet dhe më i rëndësishëm i përrallës shqiptare.

*Lëndë folklorike nga treva e Shkodrës do të japë Kasem Taipi tek "Zana Popullore", (1933). Tek botimet "Visaret e Kombit", që filluan të botohen më 1937 deri më 1944 dhe që janë 15 vëllime me përmbajtje lëndë folklorike nga gjithë viset e Shqipërisë, por kryesisht nga viset e Veriut, kontributi i folkloristave shkodranë është shumë i rëndësishëm.

*Bernardin Palaj me Donat Kurtin, më 1937, botuan në Tiranë vëllimin e dytë "Visaret e kombit - kangë kreshnikësh dhe legjenda". Këngët e kreshnikëve ishin të botuara që në numrin e parë të revistës "Hylli i dritës" të v. 1924, e cila nis me këngën: Gjeto Basho Muji. Martesa.

*Mbledhësit e vëllimeve të para të Visareve të Kombit u bënë edhe Pashko Vasa, Filip Ndoc Fishta, Karl Gurakuqi, për të vijuar me kontribute të rëndësishme të Kasem Taipit, Kolë Kamsit, Ashim Koplikut, Ramadan Sokolit, e të tjera.

*Nikolaus Rrota boton në Vjenë, më



1914 "Albanische Sprüche und Redensarten" (Fjalë dhe thënie të urta shqiptare), me 800 fjalë të urta dhe shprehje popullore shqipe.

*Ramadan Sokoli me veprat "Folklori muzikor shqiptar" (Organografia), 1975 (ribotuar 1984, 1987, 1991); "Gjurmime folklorike", (1982), "Veglat muzikore të popullit shqiptar" (bashkautor), "Gojëdhanat e botës shqiptare" (2000), ka dhënë një kontribut në folklorin muzikor jo vetëm të trevës shkodrane, por të mbarë Shqipërisë.

*Kolë Kamsi, një nga studiuesit më të mirë të proverbave të shqipes, i përmbledhi në veprën "Goja e popullit tonë - përmbledhje proverbash të krahasuara me gjuhë të tjera", (1943).

*Hamdi Bushati në veprën "Shkodra dhe motet" ka shumë përjasje me folklorin, duke përfshirë në këtë vepër 2200

vargje folklorike ndër të cilat afro 1200 ishin të panjohura deri atëherë.

*Fadil Podgorica punoi për 30 vite veprën "Fjalori etnofolklorik" (2004), një vepër e mbështetur në një material të gjërë folklorik, mbledhur nga vetë ai në zona të ndryshme të vendit si në Dukagjin, Kelmend, Kukës, Pukë, Mirditë e në të tjera treva.

*Një kontribut të veçantë kanë dhënë organet e shtypit, si "Leka", "Hylli i Dritës", "Cirka", por dhe organe të tjera, që filluan të dalin në Shqipëri, në faqet e të cilave ka pasur shumë kërkime dhe punime folklorike të trevave të hapësirës shkodrane. Rol ka luajtur edhe revista "Shejzat" e Ernest Koliqit, e botuar në Romë, e cila në rubrikat e saj ka patur shumë material folklorik.

DEDIKIM
PËR PAPA FRANÇESKUN
(me rastin e kalimit në amshim nga Sokol Palnika)

At i dashun,
 Ti shkove qetë, siç dhe jetove –
 pa bujë, pa zhurmë, por me një dritë
 që s'ka me u shue kurrë.

Na mësove me dashtë, me falë,
 me përlulë kokën,
 jo prej frike, por prej besimit.
 Në çdo fjalë tande,
 u ndje Zani i Krishtit.

Ti s'na the kurrë “shikomë mua”,
 por “shikoni Atë që më dërgoi”.
 Me kambë në tokë e me zemër në qiell,
 ecje përkrah të vujtunit,
 të harrumit, të vorfnit.

Sot, qielli u ba ma i pasun –
 e bota, pak ma e heshtun pa ty.
 Por zemra jote ka me vazhdue me folë,
 në çdo shpirt që beson,
 në Zot e në dashni.

Lamtumirë, At Françesku.
 Prehu në paqe, në krahët e Atit, sot
 e lutu për ne,
 që t'ndjekim rrugën tande
 të shndritshme
 SOT, E JETË E MOT!

“ATDHEU I KHEVSURIT”
 nga *Rafael Eristavi, Gjeorgji*

Atdheu im, – tokë me brezare,
 ku nuk rresht lahuta, kënga legjendare,
 ku njoha së pari Emrin Tënd o Zot,
 Vend i t'parve t'mi, i imi jetë e mot.

Atdheu im – me shpat e me thep,
 Me ato pak fusha ku kam ba një jetë,
 me pyje, me shkrepa, lëndina e baltë,
 ku zogjtë e malit,
 këndojnë me zë të zjarrtë.

Atdheu im – lavd' i t'parve t'mi,
 me luftë e vujtje, dashni e mëni
 me zemër malsori, me plagë në ballë,
 Ku ndër mote e shekuj, lufta nuk u ndal.

Atdheu im – lumej plot ujë mbushur,
 nën kambë t'huejve plot gjak e pluhur,
 varre që flasin, pa fjalë, pa kushtrim,
 veç heshtje që djeg si flakë vendin tim.

Atdheu im – shpirt, gjak dhe zemër
 që kurrë s'të vdes n'urí,
 për ty japim jetën,
 Mbuluar me lavdi çdo pëllëmbë dhë
 Trashëgimi e t'parëve,
 sot Ti na ke Ne.

ME RASTIN E FESTËS SË PASHKËVE, RINGJALLJES SË JEZU KRISHTIT

Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, ju uron gjithë popullit të Shkodrës, të gjithë dukagjinasve,
 kudo që janë, në Shqipëri, apo jashtë Saj:

**GËZUAR DHE PËR SHUME MOT FESTËN E PASHKËVE,
 FESTËN E RINGJALLJES SË JEZU KRISHTIT!**

Besimtarët katolik nga e gjitha bota sot kremtojnë Pashkët, ditën e madhe të Ringjalljes e të fitores së jetës ndaj vdekjes. Të gjithë besimtarëve të krishterë, në veçanti shqiptarëve, në emër të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” ju urojmë për shumë mot Pashkët.

Festa e Pashkëve simbol i një fillimi të ri, Ringjalljes, triumfi i të mirës ndaj së keqes, jetës ndaj vdekjes, shpresës ndaj dëshpërimit e të fitores ndaj dëshpërimit.

Le të gëzojmë së bashku dhe ta lejojmë gëzimin dhe shpresën e kësaj Ringjallje të na drejtojë në rrugët tona, të cilat le të jenë drejtuar nga e mira dhe e bukura.

Ti lutemi Jezusit, të na ndihmojë, që të mbjellim sa më shumë dashuri se, vetëm atëherë do të largojmë prej vetes urrejtjen e dhunën, për të jetuar në begati dhe në lumturi në familje, në bashkësi dhe në çdo veprimtari shoqërore e sociale, në marrëdhënie me njeri – tjetrin drejtë së ardhmes të sigurte në familjen Evropiane.

Pra, dashuria, shëndeti e harmonia mbizotëroftë gjithmonë në familjet tuaja!

Me shëndet Pashkën!

Gëzuar dhe për shumë mot!



REDAKSIA

Kryeredaktore: Klodjana Serraj
 Prele Milani, Lazer kodra, Lazer Stani, Roza Pjetri,
 Suela Ndoja, Zef Nika, Vuksan Kola, Zef Gjeta, Ledia
 Dushi, Leke Sokoli, Edmond Tërthorja, Lulash Brigja,
 Vilson Peshkaj, Prele Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza,
 Ndue Ziçi, Gasper Marku, Mark Gjeka.

**MUNDËSUAN BOTIMIN
 VËLLEZËRIT, ZEF,
 KRISTJAN E KLADIO
 PALI, ME BANIM NE
 KOMUNEN CUNEO,
 ITALI**

